



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

Nr. 437 Akti

Nr. 558 Vendimi  
Tiranë, më 6.9.2022

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Pamela Qirko</b>	Kryesuese
<b>Roland Ilia</b>	Relator
<b>Etleda Çiftja</b>	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Amela Idrizi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në datën 1.9.2022, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Bajram Breçani**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar.

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

## **TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT**

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionerin Roland Ilia, dëgjoi subjektin e rivlerësimit dhe vëzhguesin ndërkombëtar, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Bajram Breçani, i cili në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë,

### **V Ë R E N:**

#### **I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

**1.** Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5, të nenit 179/b, të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1, të nenit 5, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**2.** Subjekti i rivlerësimit Bajram Breçani, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është subjekt i rivlerësimit që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio* në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

**3.** Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në muajin dhjetor të vitit 2019, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit Bajram Breçani do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr.1, i përbërë nga komisionerët Pamela Qirko, Roland Ilia dhe Etleda Çiftja.

**4.** Për këtë subjekt rivlerësimi u caktua me mirëkuptim kryesues i trupit gjykues komisionere Pamela Qirko, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Bajram Breçani.

**5.** Në referim të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit Bajram Breçani, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

**6.** Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016 dhe, veçanërisht, në nenin 30 të këtij ligji kishte për objekt të vlerësimit deklarin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

**7.** Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të

Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP). Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

**8.** Në përputhje me nenet 30-33 të ligjit nr. 84/2016 u administrua akti i kontrollit me nr. \*\*\* prot., datë 21.6.2019, i ILDKPKI-së, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 25.6.2019, ku është kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit.

**9.** DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport për subjektin e rivlerësimit, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 31.5.2022 (deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\* , datë 26.5.2022, të KDZH-së), në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

**10.** KLP-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në të dhënat e rezultuara nga tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti, pesë dokumentet ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe nga të dhënat arkivore të këtij Këshilli. Raporti me nr. \*\*\* prot., datë 22.4.2022, i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, është protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 12.5.2022.

**11.** Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm për të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimin e pasurisë; kontrollin e figurës; si dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

**12.** Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për të tria kriteret e vlerësimit – vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale, në datën 28.1.2022, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit Bajram Breçani; (ii) njoftimin e subjektit për t’u njohur me materialet e dosjes; si dhe (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

**13.** Subjekti i rivlerësimit u njoftua në datën 12.7.2022 mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti, pasi u njoh me aktet e dosjes, ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja deri më 25.7.2022.

**14.** Subjekti i rivlerësimit, pasi u njoh me dosjen dhe ka marrë një kopje të saj, ka dërguar shpjegimet në rrugë zyrtare. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim shpjegimet e paraqitura dhe provat mbështetëse mbi rezultatet e hetimit në datën 25.7.2022, vendosi të ftojë z. Bajram Breçani në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

**15.** Subjekti i rivlerësimit Bajram Breçani u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin e bërë në rrugë zyrtare me shkresën me nr. \*\*\* prot., në datën 25.7.2022.

**16.** Seanca dëgjimore me subjektin u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 27.7.2022, ora 14:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëta, seancë e cila nuk u zhvillua e plotë. Nga salla e seancave publike, përfaqësuesi ligjor i subjektit të rivlerësimit, z. E.Sh, dorëzoi prokurën e dhënë nga subjekti i rivlerësimit si dhe njoftoi pamundësinë e z. Breçani për të marrë pjesë në seancë për shkaqe shëndetësore duke i paraqitur trupit gjykues dhe raportin mjekësor. Në vijim të kësaj, përfaqësuesi ligjor kërkoi shtyrjen e seancës dëgjimore me argumentin se i duhej kohë në dispozicion për t’u njohur me materialet e dosjes së subjektit Bajram Breçani. Trupi gjykues, në prani dhe të vëzhguesit ndërkombëtar pasi verifikoi raportin mjekësor si dhe prokurën e lëshuar nga subjekti i rivlerësimit për përfaqësuesin ligjor z.E.Sh, vendosi të shtyjë seancën dëgjimore për në datën 1.9.2022, ora 10:00.

Seanca e dytë dëgjimore u zhvillua në datën 1.9.2022 ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish- Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*) Tiranë, në prani dhe të vëzhguesit ndërkombëtar seancë në të cilën ishte prezent subjekti i rivlerësimit z. Bajram Breçani së bashku me përfaqësuesin e tij ligjor z. E.Sh.

**17.** Subjekti i rivlerësimit mori kohën e kërkuar për të shprehur dhe për të parashtruar shpjegimet dhe opinionet e saj në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit Bajram Breçani kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

## **III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

**18.** Z. Bajram Breçani ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ ka zbatuar afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur i janë kërkuar. Subjekti ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

#### **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI**

**19.** Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

**20.** Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

**20.1** Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

**20.2** Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

**20.3** Ndërsa, sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016 parashikohet objekti i rivlerësimit të aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

**21.** Referuar vendimit nr. 2/2017<sup>1</sup> të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

**22.** Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;

---

<sup>1</sup>“41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: ‘Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit’. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: ‘Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë’. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

- c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe deklaratat periodike vjetore të dorëzuara ndër vite, nga subjekti në ILDKPKI;
- ç) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- d) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
- dh) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLP-ja;
- e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

## **A. VLERËSIMI I PASURISË**

Bazuar në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar dhe në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ka paraqitur në Komision raportin e vlerësimit për subjektin Bajram Breçani.

Subjekti i rivlerësimit Bajram Breçani është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2013, ku ka dorëzuar, ndër vite, deklaratat e interesave private: para fillimit të detyrës në vitin 2013; periodike/vjetore 2013 – 2016; dhe deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*.

Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, nga ILDKPKI-ja, në përputhje me pikën 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, është konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka mungesë dokumentacioni ligjor, si dhe mosdeklarim të pasurisë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

### **A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni**

**23.** Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) provat shkresore/dokumentet të/e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- ç) deklaratimet e subjektit me anë të komunikimit elektronik;
- d) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit.

**24.** Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni nisi shqyrtimin e deklarimeve të interesave private dhe

pasurore, të paraqitura më parë te ky institucion, duke i krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit Bajram Breçani, pas:

- a) shqyrtimit të të dhënave të deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, me nr. indeksi \*\*\*, për subjektin e rivlerësimit;
- b) krahasimit të deklaratave të pasurive të dorëzuara në ILDKPKI për periudhën 2013-2016, në raport me të dhënat në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*;
- c) shqyrtimit të të dhënave nga të gjitha bankat e nivelit të dytë, institucionet financiare dhe jofinanciare, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, organet tatimore, organet e tjera shtetërore, personat juridikë, individët, si dhe likuiditeteve – gjendje *cash*;
- ç) hetimit të kryer lidhur me të dhënat e vetëdeklaruara nga subjekti gjatë plotësimit të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni.

Në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, të dorëzuar në ILDKPKI, subjekti i rivlerësimit Bajram Breçani dhe personat e lidhur kanë deklaruar pasuritë si në vijim:

## **1. Shtëpi banimi, rruga “\*\*\*”, Tiranë**

**1.1** Subjekti ka deklaruar se disponon një shtëpi banimi me sip. 145 m<sup>2</sup> me sip. trualli 460 m<sup>2</sup> dhe një pjesë shpati rreth 300 m<sup>2</sup> në pjesën lindore, e konfirmuar nga kontrata e datës 16.6.1998, e përbashkët me vëllezërit, blerë pronarëve H dhe M.B në fund të vitit 1995, pa dokumente ligjore dhe e kthyer me dokumente ligjore sipas kontratës së blerjes më 16.6.1998, në vlerën 368.000 lekë. Pasuri e regjistruar në ZVRPP më 22.6.1998. Burimi i të ardhurave është nga të tre vëllezërit, ku pjesa takuese është afërsisht 123.000 lekë. Vlera në shifra 3.000.000 lekë për ndërtimin dhe 2.500.000 lekë për arredim dhe punime të brendshme.

**1.2** Burimi i të ardhurave janë dokumentet justifikuese të poshtëshënuara të paraqitura nga subjekti:

*“Trualli, banesa dhe muri rrethues ndodhen në z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, nr. rendor \*\*\*, rruga ‘\*\*\*’, Tiranë. Kjo banesë ndodhet në godinën trekatëshe, tre hyrjesh, për të cilën është shpenzuar shuma 8.000.000 lekë në total dhe është ndërtuar me kontributet e mia dhe të vëllezërve të mi A.U. B dhe B.U.B, i cili nga viti 1993 – 1996 ka qenë emigrant në Firenze, Itali. Objekti trekatësh është i ndarë me pjesë të barabarta prej 33.3%/secili. Unë, për ndërtimin e kësaj banese, kam shpenzuar 3.000.000 lekë dhe për rregullimin dhe arredimin rreth 2.500.000 lekë. Ndërtimi i kësaj banese ka filluar në fundin e vitit 1996, fillimviti 1997. Burimi i të ardhurave për ndërtimin e pjesës takuese të banesës sime janë:*

*Shitja e banesës me kontratë noteriale nr. \*\*\*, datë 16.1.1997, në vlerën 2.000.000 lekë (banesë e cila ka qenë në bashkëpronësi me vëllain tim B.U.B, me pjesë takuese 50% me 50%, që do të thotë 1.000.000 lekë të reja secili prej nesh. Sqaroj: banesa e shitur me kontratë noteri nr. \*\*\*, datë 16.1.1997, është blerë nga unë dhe vëllai im B.U.B, në shumën 1.650.000 lekë, me kontratë noterie nr. \*\*\*, datë 29.1.1996, me pjesë takuese 50% me*

50%, e konvertuar në 825.000 lekë, nga të cilat shuma prej 675.200 lekësh është e siguruar nga të ardhurat e fondacionit ‘\*\*\*’ sipas mandatpagesave (në datat 22.11.1995, 3.7.1995, 30.8.1995), duke respektuar normat ligjore, të njohura nga shteti shqiptar, mbi bazën e të cilave funksiononte ky fondacion. Ndërsa, pjesa prej 149.800 lekësh është paguar nga vëllai im B.U.B, njëkohësisht dhe bashkëpronar në këtë banesë. Këtë shumë ia kam kthyer vëllait me shitjen e kësaj banese, pasi nga kjo shitje kemi fituar shumën 350.000 lekë të reja.

Gjithashtu, burim i krijimit të të ardhurave për ndërtimin e pjesës takuese në banesën private me sip. prej 145 m<sup>2</sup>, truallit dhe murit rrethues të banesës është aktmarrëveshja nr. \*\*\*. i regj., datë 12.3.1997, që përcakton shitjen e banesës shtetasit A.Ll.C në Lushnjë, lagjja “\*\*\*”, kontratë noteriale shitjeje nr. \*\*\*, datë 6.9.2001.

E ardhur tjetër e shfrytëzuar për ndërtimin e banesës dhe murit rrethues është edhe shuma prej 500.000 lekësh që vjen nga mandatpagesa nr. \*\*\*, datë 20.7.1996, nga fondacioni ‘\*\*\*’, i njohur nga ligji shqiptar i asaj kohe, veprimet kontraktuese nga ana ime me këtë fondacion janë kryer sipas ligjit dhe statutit që mbante ky fondacion. Sqaroj se i kam marrë vëllait tim B.U.B huan në shumën 600.000 lekë, të cilën e kam kthyer në vitin 2003, para të ardhura nga kursimet e mia të pagës dhe kreditë e marra nga PSHM-ja dhe sot e quajtur NOA”.

**1.3** Për të provuar deklaratimet e subjektit për këtë pasuri janë administruar dokumentacionet shkresore:

- kontratë noteriale blerjeje nr. \*\*\*, datë 29.1.1996;
- kontratë noteriale shitje nr. \*\*\*, datë 16.1.1997;
- mandatpagesat datë 22.11.1995, datë 30.8.1995, datë 3.7.1995, nr. \*\*\*, datë 20.7.1996;
- aktmarrëveshje noteriale nr. \*\*\* regj., datë 12.3.1997;
- kontratë noteriale nr. \*\*\*;
- kontratë blerje truallit nr. \*\*\*;
- vërtetim pronësie lëshuar nga ZVRPP-ja Tiranë më 22.6.1998;
- kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2016, nga ZVRPP-ja Tiranë;
- kthim përgjigjeje nga Drejtoria e Përgjithshme ALUIZNI nr. \*\*\* prot., datë 17.11.2016, që provon vetëdeklarimin për legalizimin e objektit trekatësh në pronësi të tre vëllezërve;
- vërtetim i lëshuar nga NOA (ish PSHM) nr. \*\*\* prot., më 20.1.2017 (kredi në shumën 2.800 USD, në datën 6.6.2002 dhe e shlyer totalisht më 30.3.2006, kredi në shumën 1.500 USD, në datën 29.10.2003, e shlyer totalisht më 30.3.2006;
- vërtetim i lëshuar datë 20.1.2017, nga NOA, për kredinë e marrë në vlerën 12.000 euro, e përdorur për punime të brendshme dhe arredim banese;
- aktmarrëveshje për vendosje depozite në BKT, më 16.4.1997, nga vëllai B.U.B që konfirmon depozitimin e të ardhurave të fituara në Itali dhe të depozituara në bankë pas kthimit nga Italia.



## Hetimi i kryer nga Komisioni

**1.4** Pasuria në fjalë është deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting* dhe rezultoi se është krijuar në periudhën që subjekti ushtronte detyrën e prokurorit në Republikën e Shqipërisë (prokuror në Lushnjë) dhe për këtë iu nënshtrua hetimit administrativ lidhur me saktësinë e deklarimeve dhe burimin e ligjshëm të krijimit.

**1.5** ZVRPP-ja Tiranë<sup>2</sup> (ASHK) konfirmon që truall me sip. 460 m<sup>2</sup> është në bashkëpronësi të shtetasve Bajram dhe B.B. Regjistrimi është bërë në bazë të kontratës së shitjes nr. \*\*\*, datë 16.6.1998. Pra, pasuria truall është blerë dhe është regjistruar në emër të dy bashkëpronarëve dhe jo tre bashkëpronarëve, siç ka deklaruar subjekti në deklaratën *Vetting*.

**1.6** Bashkëlidhur përgjigjes së ASHK-së është paraqitur dhe administruar dokumentacioni:

- kartela e pasurisë së paluajtshme nr. \*\*\*, lloji “truall” me sip. 460 m<sup>2</sup>, në emër të shtetasve Bajram Breçani dhe B.B; në seksionin e hipotekave shënohet se ka dy ndërtime të paligjshme;
- kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 16.6.1998, nënshkruar ndërmjet palës shitëse H.B, M.B dhe palës blerëse B.B dhe B.B, të një sipërfaqeje truall prej 460 m<sup>2</sup>, kundrejt vlerës 800 lekë/m<sup>2</sup>, likuiduar totalisht nga blerësit;
- vërtetim pronësie lëshuar më 22.6.1998.

**1.7** Bazuar në të dhënat e marra nga ASHK-ja<sup>3</sup> rezulton se kartela e pasurisë truall dhe ndërtesë është në emër të subjektit të rivlerësimit dhe vëllait të tij B.B, përkatësisht me nga ½ pjesë takuese.

**1.8** FSHU-ja<sup>4</sup> nuk konfirmon që subjekti i rivlerësimit të jetë abonent dhe të ketë kontratë të furnizimit me energji elektrike.

**1.9** Në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2013 subjekti ka deklaruar: “*Shtëpi banimi 3 kate me sip. 145m<sup>2</sup> x 3, e ndodhur në rrugën ‘\*\*\*’, e ndërtuar në bashkëpronësi me vëllain në vitin 1996, me të ardhura nga shitja e apartamenteve të mëparshëm në Bajram Curri dhe Lushnjë, si dhe të ardhurat e vëllait emigrant në Itali (në proces legalizimi). Vlera: 8.000.000 lekë. Pjesa takuese: 50%*”.

**1.10** Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t<sup>5</sup>, për praktikën e vetëdeklarimit të bërë nga shtetasit Bajram Breçani dhe B.B, ka paraqitur dokumentacionin:

- vetëdeklarim për legalizimin e objektit “banesë”, datë ndërtimi 5.10.1998, nga shtetasit Bajram Breçani dhe B.B, me vendndodhje në rrugën “\*\*\*”, Tiranë, sipërfaqe e zënë 663 m<sup>2</sup>, sipërfaqe e ndërtimit 150 m<sup>2</sup>, nr. i kateve mbi tokë 3;
- certifikatat familjare të dy familjeve Breçani;

<sup>2</sup>Shihni shkresat e ZVRPP-së në dosjen e ILDKPKI-së dhe Komisionit.

<sup>3</sup>Shihni certifikatën e pasurisë për objektin dhe truallin në dosjen e Komisionit.

<sup>4</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 7.7.2020, të FSHU-së në dosjen e Komisionit.

<sup>5</sup>Shihni shkresat e ALUIZNI-t në dosjen e ILDKPKI-së dhe Komisionit, shkresë nr. \*\*\* rep., datë 22.7.2020.

- procesverbal konstatimi i mbajtur në datën 9.9.2014 nga Drejtoria e ALUIZNI-t Tiranë, kontrata e blerjes së truallit ku është ndërtuar objekti datë 16.6.1998, sip. 460m<sup>2</sup>, palë blerëse B dhe Bajram Breçani, palë shitëse H dhe M.B, me vlerë shitjeje 368.000 lekë;
- planvendosje e pronës dhe foto të objektit.

**1.11** Gjithashtu, ALUIZNI<sup>6</sup> konfirmon dhe se subjekti Bajram Breçani figuron vetëdeklarues pranë Njësisë Vendore Nr. \*\*\*, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 17.8.2006, bashkëlidhur së cilës gjendet dokumentacioni:

- relacion tekniko-ligjor datë 17.8.2008, kualifikim për legalizim të objektit “banesë” me pronar Bajram Breçani, nr. \*\*\* prot., viti 2006, rruga “\*\*\*\*”;
- vetëdeklarim për legalizim datë 17.8.2006 të objektit “banesë”, rruga “\*\*\*\*”, Tiranë, me deklarues Bajram Breçani dhe B.B, funksioni i objektit për banim, viti i ndërtimit 5.10.1998, sipërfaqe e zënë 663 m<sup>2</sup>, sipërfaqe e ndërtimit 150 m<sup>2</sup>, numri i kateve mbi tokë 3;
- planvendosje e pronës së shtetasve B dhe Bajram Breçani;
- përbërja familjare e kryefamiljarit Bajram Breçani;
- përbërja familjare e kryefamiljarit B.B;
- vërtetim pronësie datë 22.6.1998 dhe fotografi të objektit për legalizim.

**1.12** Bazuar në dosjen e paraqitur nga subjekti për legalizim rezulton se vetëm subjekti i rivlerësimit dhe vëllai i tij B.B kanë aplikuar për legalizim objekti pa leje. Bazuar në relacionin tekniko-ligjor të Bashkisë Tiranë (datë 17.8.2008), kualifikimi i objektit ndërtues për legalizim është bërë vetëm në emër të subjektit të rivlerësimit.

**1.13** Komisioni hetoi lidhur me të ardhurat e deklaruara nga subjekti, të cilat janë deklaruar si burim për blerjen e kësaj pasurie.

**1.14** Të ardhura nga shitja e banesës në Tiranë:

- Rezultoi se me kontratë noteriale nr. \*\*\*, datë 16.1.1997 është bërë shitja e banesës në vlerën 2.000.000 lekë (banesë e cila ka qenë në bashkëpronësi të subjektit me vëllain B.U.B, me pjesë takuese 50% me 50%) .
- Kjo banesë është blerë më parë nga subjekti dhe vëllai i tij B.U.B në shumën 1.650.000 lekë, me kontratë noterie nr. \*\*\*, datë 29.1.1996. Pra. me pjesë takuese 50% me 50% dhe në vlerë monetare kontributi i subjektit rezulton 825.000 lekë. Subjekti ka deklaruar se burimi për blerjen e kësaj pasurie janë të ardhurat e përfituara nga fondacioni “\*\*\*\*”.
- Nuk dokumentohet kalimi i shumës nga pala shitëse të subjekti i rivlerësimit dhe vëllai i tij, por në kontratë deklarohet se shuma është paguar në momentin e lidhjes së kontratës së shitblerjes.

---

<sup>6</sup>Shihni shkesat e ALUIZNI-t në dosjen e ILDKPKI-së dhe Komisionit.

### **1.15** Të ardhura nga shitja e banesës në qytetin e Lushnjës:

- Me vërtetim nga dokumentet hipotekore nr. \*\*\*, datë 6.9.2001, figuron e regjistruar pasuria apartament me sip. 69.7 m<sup>2</sup>, në emër të shtetasve Bajram Breçani dhe H. B.
- Me aktmarrëveshjen nr. \*\*\* rep., datë 12.3.1997, nënshkruar ndërmjet shtetasve Bajram Breçani dhe A.C, për shitjen e banesës në Lushnjë, është deklaruar se shtetasi A.C i ka likuiduar shtetasit Bajram Breçani shumën 1.000 USD dhe i detyrohet edhe 8.612 USD për shlyerjen totale të banesës.
- Me kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 6.9.2001, nënshkruar ndërmjet palës shitëse Bajram dhe H.B dhe palës blerëse A.C është kryer shitja e banesës me sip. 69.7 m<sup>2</sup>, në Lushnjë, z. k. \*\*. Vlera e shitjes së banesës: 1.500.000 lekë.
- Nuk dokumentohet kalimi i shumës dhe periudha përkatëse nga pala shitëse e subjektit të rivlerësimit, pasi në aktmarrëveshjen e vitit 1997 deklarohet se është paguar vetëm një pjesë e shumës prej 1.000 USD dhe jo pagimi i shumës së mbetur prej 8.612 USD. Sipas kontratës së shitjes (datë 6.9.2001) vlera prej 1.500.000 lekësh është likuiduar tërësisht nga blerësi, para nënshkrimit të kësaj kontrate.

### **1.16** Të ardhurat nga fondacioni “\*\*\*”:

- Bazuar në mandatpagesën datë 22.11.1995 dukej se është arkëtuar shuma 600.000 lekë dhe mandatpagesën nr. \*\*\*, datë 30.8.1995, arkëtuar shuma 37.600 lekë, nga subjekti Bajram Breçani si përfitime nga fondacioni Rr.Xh.

**1.17** Me mandatpagesën datë 3.7.1995 është arkëtuar shuma prej 37.600 lekësh dhe me mandatpagesën nr. \*\*\*, datë 20.7.1996, është arkëtuar nga subjekti shuma prej 500.000 lekësh, si të ardhura të përfituara nga fondacioni “Rr.Xh”.

**1.18** Lidhur me vërtetimin e këtyre të ardhurave nga fondacioni “Rr. Xh”, Komisioni iu drejtua Ministrisë së Financave<sup>7</sup> dhe në përgjigje të shkresës është deklaruar se “... disponohen shumë pak dokumente si mandatarkëtime, mandatpagesa për kreditorët e kësaj kompanie” dhe nuk konfirmon saktësinë e tyre.

**1.19** Me deklaratën noteriale (për njohje shpenzimesh financiare) nr. \*\*\*, datë 28.10.2016, lëshuar nga shtetasit A.B dhe B.B deklarohet se këta shtetas kanë investuar vlera financiare për ndërtimin e një godine 3-katëshe të ngritur mbi truallin me sip. 145 m<sup>2</sup>. Trualli është i regjistruar në emër të shtetasve B.B dhe B.Breçani. Sipas deklaruesve, vlera e investuar në objekt është rreth 8.000.000 lekë, ku shtetasi Bajram Breçani ka investuar shumat 3.000.000 lekë për ndërtimin e objektit dhe 2.000.000 lekë për punime të brendshme. Kontributi i tij financiar përfshin periudhën 1996 – 2003. Shtetasi A.B ka investuar shumën 2.000.000 lekë, kurse shtetasi B.B 3.000.000 lekë. Burimi i të ardhurave për shtetasin A.B është nga veprimtaria private në tregtim artikuj të ndryshëm, ndërsa e shtetasit B.B është nga emigracioni në Itali dhe, më pas, në SHBA.

---

<sup>7</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 31.5.2022, drejtuar MFE-së, shoqërisë huamarrëse në administrim.

**1.20** Për sa i përket kësaj pasurie, mospërputhjet në deklaratime dhe për kontributin e kryer mbi ndërtimin e saj është pyetur subjekti, i cili në përgjigje të pyetësorit nr. 2<sup>8</sup>, ka deklaruar:

*“Lidhur me faktin se në deklarin për legalizim nuk është përmendur emri i vëllait tim shtetasit A.B, kjo është bërë pasi ai nuk ishte në Tiranë, por në qytetin e Bajram Currit në momentin e hartimit dhe dorëzimit të vetëdeklarimit për legalizim pranë ALUIZNI-t (sqaroj se vetëdeklarimi është dorëzuar në vitin 2006 dhe unë në atë kohë nuk isha subjekt rivlerësimi).*

*Gjithashtu, në deklaratën para fillimit të detyrës deklarimi është bërë në përputhje me formularin e vetëdeklarimit të ALUIZNI, pasi në atë kohë për shkak edhe të mungesës së eksperiencës në plotësimin e deklaratimit të pasurisë, nuk i kam kushtuar rëndësinë e duhur këtij fakti dhe kam pasqyruar gjendjen sipas dokumentacionit provues që kisha dhe jo gjendjen reale të bashkëpronësisë në objekt.*

*Tokën e kemi blerë unë dhe vëllai im B.B. Vëllai tjetër A.B na ka kërkuar që të ndërtonte një kat edhe ai në objektin që ne po ndërtonim dhe ne kemi rënë dakord që ta lejojmë të ndërtojë katin e tretë të objektit.*

*Objekti është ndërtuar pa leje në pronën tonë dhe i është nënshtruar procedurave të legalizimit. Punimet në objekt nuk janë kryer me kompani ndërtimi, por me punëtorë dhe shpesh herë kemi punuar dhe unë dhe familjarët e mi. Në këto kushte nuk kemi bërë preventiva apo situacione punimesh. I vetmi dokumentacion ligjor provues në lidhje me vlerën e kësaj pasurie është një aktekspertimi i hartuar nga ana e ekspertës së licencuar.*

*Aktualisht, vetëm unë me familjen time kam përdorur gjatë gjithë kohës dhe vazhdoj të përdor katin e dytë të banesës. Vëllai im B.B, për shkak se jeton në shtetet e Bashkuara të Amerikës, banesën e ka në katin e parë dhe banon në të kur vjen me pushime nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, gjatë pjesës tjetër të vitit në banesë nuk banon njeri. Nga viti 2004 deri në vitin 2014, banesa e vëllait tim, B.B është përdorur nga vëllai tjetër A.B dhe, për këtë arsye, librezja e energjisë elektrike është në emër të tij akoma. Sa i përket katit të tretë të banesës në të nuk ka ardhur për të banuar ende vëllai tjetër A.B, pasi ai jeton ende në qytetin e Bajram Currit dhe nuk e ka përfunduar ende plotësisht ndërtimin e banesës”.*

**1.21** Pas hetimit dhe administrimit të dokumentacionit për këtë pasuri u konstatuan problematikat:

- Gjatë hetimit rezultoi se trualli mbi të cilin është ndërtuar objekti është blerë<sup>9</sup> nga subjekti dhe vëllai i tij B.B, me vlerë totale 368.000 lekë (kontributi i secilit i llogaritur në analizën financiare në shumën 184.000 lekë).

<sup>8</sup>Shihni përgjigjet e subjektit mbi pyetësorin nr. 2 në dosjen e Komisionit.

<sup>9</sup>Provuar kjo me kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 16.6.1998 dhe nëpërmjet shkresës së ASHK-së<sup>9</sup> ku rezulton se data e lëshimit të certifikatës është 7.2.2019, ndërsa data e regjistrimit është 20.11.2004, në bashkëpronësi midis Bajram dhe B.B.

- Bazuar në formularin<sup>10</sup> e vetëdeklarimit për legalizimin e objektit, i dorëzuar pranë ALUIZNI-t, rezultoi se ky formular është plotësuar vetëm nga z. B.B dhe subjekti i rivlerësimit.
- Në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2013 subjekti ka deklaruar se blerja e truallit dhe ndërtimi i objektit është bërë nga ai dhe vëllai i tij B.B
- Subjekti, deri më sot, nuk ka kryer ndonjë veprim për të provuar pretendimet e tij se pasuria në fjalë është ndërtuar me kontributin e tre vëllezërve dhe as nuk janë kryer veprime për ndarjen e pasurisë në emër të tyre respektiv.
- Bazuar në kartelën e pasurisë sipas ASHK-së, pasuria në fjalë si truall dhe objekti figuron vetëm në emër të subjektit të rivlerësimit dhe vëllait të tij B.B në bashkëpronësi.
- Nuk vërtetohet periudha e ndërtimit të objektit dhe kostot e saj.
- Ndërtimi i objektit pa leje ndërtimi dhe zënia e truallit është bërë gjatë periudhës që subjekti ushtronte detyrën e prokurorit.

**1.22** Komisioni hartoi analizën financiare për krijimin e pasurisë duke konsideruar se investitorët e ndërtimit të saj janë z. B dhe z. Bajram Breçani, ndërsa vëllai i tyre z. A B nuk është përfshirë pasi:

- Subjekti ka përcjellë me deklaratën *Vetting* deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 28.10.2016, të deklaruësve A dhe B.B, ku deklarohet se vlera e investuar në objekt është 8.000.000 lekë, nga e cila 2.000.000 lekë janë investuar prej z. A.B. Konstatohet se kjo deklaratë nuk është përfshirë në përgjigjen e përcjellë në Komision prej ALUIZNI-t, si pjesë e procesit të legalizimit të objektit, madje në përmbajtje të saj lexohet shprehimisht: *“Deklaruesit më pohojnë se e bëjnë këtë deklaratë noteriale për efekte ligjore e morale dhe për të theksuar faktin e shpenzimeve financiare për ndërtimin e godinës së mësipërme”*. Gjithashtu edhe nga sistemi *online* i ASHK-së (IPS) informohet se në kartelën e pasurisë bashkëpronësia është e shtetasve B dhe Bajram Breçani.
- Sipas përgjigjes së subjektit në pyetësorin nr. 2 është deklaruar se z. A.B<sup>11</sup> ka banuar dhe banon në qytetin e Bajram Currit.
- Sipërfaqja e ndërtimit të objektit është konsideruar sipas procesverbalit të konstatimit<sup>12</sup> të mbajtur në datën 9.9.2014, ku rezulton se sipërfaqja e bazës së objektit është 148.6m<sup>2</sup>, ndërsa sip. e përgjithshme e ndërtimit është 555.3 m<sup>2</sup>, prej ku kati përdhës 186,6m<sup>2</sup>, kati i parë 182,1 m<sup>2</sup> dhe kati i dytë 186,6 m<sup>2</sup>. Në analizën e burimit të krijimit është llogaritur kontributi i subjektit të rivlerësimit për gjysmën<sup>13</sup> (50% pjesë takuese) e kësaj sipërfaqeje.

<sup>10</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 22.7.2020, e ASHK-së.

<sup>11</sup>Gjithashtu, subjekti përcjell edhe kontratën e blerjes së apartamentit në vitin 2005 prej Entit Kombëtar të Banesave nga shtetasi A.B, në qytetin e Tropojës (dosja ILDKPKI, f. \*\*\*).

<sup>12</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 22.7.2020, nga ASHK-ja.

<sup>13</sup>555.3 m<sup>2</sup> :2 = 277.7 m<sup>2</sup>.

- Vlera e investimit<sup>14</sup> është llogaritur mbi referencat e kostove të EKB-së të viteve 1996, 1997 dhe 1998, pasi koha e investimit është shtrirë në tre vite, prej së cilës rezulton se vlera e gjysmës së ndërtimit të objektit është 4.921.492 lekë.<sup>15</sup>
- Shpenzimet e arredimit, mobilimit dhe përshtatjes janë konsideruar sa deklaruar në deklaratën *Vetting* prej subjektit të rivlerësimit në shumën 2.500.000 lekë, ndërsa në lidhje me periudhën e investimit/blerjes së tyre është konsideruar deklarimi i subjekti të rivlerësimit në pyetësin standard<sup>16</sup>.

**1.23** Në lidhje me të ardhurat, të cilat kanë shërbyer si burim për krijimin e pasurisë së mësipërme u konstatua se:

- a) Për të ardhurat e deklaruara nga subjekti me vlerë 500.000 lekë dhe me burim fondacionin bamirës “\*\*\*\*” është përcjellë<sup>17</sup> mandatpagesa nr. \*\*\*, datë 20.7.1996, nga fondacioni “\*\*\*\*”, deri në këto momente nuk është konsideruar e ardhur e ligjshme, duke qenë se nuk u arrit të provohej përfitimi i tyre dhe shlyerja e detyrimeve tatimore për vlerën e fituar nga ky investim monetar. Gjithashtu, këto të ardhura nuk u arritën të konfirmohen as nga Ministria e Financave<sup>18</sup> për shkak të mungesës së dokumentacionit provues nga ana e tyre.
- b) Të ardhurat nga apartamenti në rrugën “\*\*\*\*”<sup>19</sup>, Tiranë, shitur me kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, lidhur në datën 16.1.1997, me vlerë shitjeje 2.000.000 lekë, janë përfshirë në analizën e burimit të krijimit me pjesë takuese 50% dhe pasi është zbritur vlera e kthimit të huas prej 148.800 lekësh vëllait të tij, z. B.B<sup>20</sup>.
- c) Të ardhurat nga shitja e apartamentit të ndodhur në qytetin e Lushnjës janë përfshirë në analizën e krijimit të pasurisë, mbështetur në aktmarrëveshjen nr. \*\*\* rep., datë 12.3.1997<sup>21</sup> dhe në kontratë shitblerjeje nr.\*\*\*, datë 6.9.2001<sup>22</sup>.
- d) Hua e marrë nga vëllai, z. B.B, me vlerë 600.000 lekë për të cilën përcillet aktmarrëveshja<sup>23</sup> për vendosje depozite në BKT, datë 16.4.1997, me burim të ardhurat nga emigracioni në Itali.

<sup>14</sup>Vlera e investimit e deklaruar në deklaratën *Vetting* është 3.000.000 lekë.

<sup>15</sup>277.7 m<sup>2</sup>/3 vite x (16 567 lekë/m<sup>2</sup> +16 567 lekë/m<sup>2</sup> +20 033 lekë/m<sup>2</sup>).

<sup>16</sup>Përgjigjja nr. \*\*\*, “Siç kam deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe ILDKPKI gjithë arredimi së bashku me punimet e brendshme ka kushtuar rreth 2.500.000 lekë, ku pjesë dërrmuese të këtyre shpenzimeve e kanë zënë punimet e brendshme, sa i përket mobilimit dhe pajisjeve elektrike këto janë blerë kur kemi hyrë në shtëpi në vitin 1998 dhe nuk disponojmë fatura për çmimin e tyre”.

<sup>17</sup>Përcjellë me deklaratën *Vetting* aneks \*\*\*, por edhe gjatë hetimit me pyetësin nr. 2 dhe nr. 3.

<sup>18</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 31.5.2022, drejtuar MFE-ja, shoqërisë huamarrëse në administrim.

<sup>19</sup>Origjina e burimit të krijimit të këtij apartamenti prej subjektit është deklaruar nga të ardhurat e tërhequra prej tij në fondacionin bamirës “\*\*\*\*”, në shumën 675.200 lekë, provuar me mandatpagesat (datë 22.11.1995, 3.7.1995, 30.8.1995) dhe pjesa prej 149.800 lekësh i është marrë hua vëllait të tij B.B.

<sup>20</sup>Në deklaratën *Vetting* subjekti deklaron se i ka marrë hua vlerën 149.800 lekë për t’u përdorur për plotësimin e vlerës së blerjes së apartamentit, të ndodhur në Tiranë. Subjekti deklaron se vlera e huas është shlyer prej vlerës së shitjes së apartamentit.

<sup>21</sup>Nënshkruar ndërmjet shtetasve Bajram Breçani dhe A.C, për shitjen e banesës në Lushnjë, ku është deklaruar se shtetasi A.C i ka likuiduar shtetasit Bajram Breçani shumën 1.000 USD dhe i detyrohet edhe 8.612 për shlyerjen totale të banesës.

<sup>22</sup>Nënshkruar ndërmjet palës shitëse Bajram e H.B dhe palës blerëse A.C, është kryer shitja e banesës me sip. 69.7 m<sup>2</sup> në Lushnjë, në z. k. \*\*\*. Vlera e shitjes së banesës 1.500.000 lekë është likuiduar tërësisht nga blerësi, para nënshkrimit të kësaj kontrate.

<sup>23</sup>Përcjellë me deklaratën *Vetting*, aneks \*\*\* dhe me pyetësin nr. 3.

**1.24** Në përmbledhje të sa më sipër është hartuar analiza e burimit të krijimit të pasurisë si në vijim.

	<b>Vlera në lekë</b>
<b>Investimi i subjektit të rivlerësimit në gjysmën e objektit</b>	<b>7 605 492</b>
Blerja e truallit	184 000
<i>Sip. e ndërtimit - 277,7 m<sup>2</sup></i>	
<i>EKB e vitit 1996 dhe 1997 - 16,567 lekë/m<sup>2</sup></i>	
<i>EKB e vitit 1998 - 20,033 lekë/m<sup>2</sup></i>	
Vlera e ndërtimit të 50% të objektit	4 921 492
Shpenzime arredimi dhe punimet e brendshme	2 500 000
<b>Burimi</b>	<b>2 881 715</b>
Të ardhura nga shitja e banesës në qytetin e Lushnjës	1 500 000
Vlera e të ardhurave nga shitja e banesës në rrugën “****”, Tiranë, datë 16.1.1997, pasi është zbritur vlera e huas, kthyer vëllait (149,800 lekë)	850 200
Hua e marrë prej vëllait B.B e kthyer në vitin 2003	600 000
Të ardhura sipas mandatpagesës nr. ***, datë 20.7.1996, nga fondacioni “Xh”	0
<b>Rezultati</b>	<b>- 4 655 292</b>

**1.25** Bazuar në analizën financiare, subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare për të kryer investimin në pasurinë godinë 3-kate + truall (rezultoi në pamundësi financiare në vlerën 4.655.292 lekë).

**1.26** Në përfundim të hetimit për krijimin e kësaj pasurie, subjektit i kaloi barra e provës për të gjitha konstatimet e bëra më sipër nga Komisioni dhe për ato që vërehen si vijon:

- a. Ka mospërputhje në deklaratimet e subjektit lidhur me personat që kanë kontribuar në blerjen e truallit dhe ndërtimin e pasurisë shtëpi banimi<sup>24</sup>.
- b. Subjekti nuk arrin të provojë me dokumentacion vlerën e investimit dhe kontributin e secilit nga vëllezërit sipas deklaratimit të subjektit.
- c. Pasuria (truall dhe objekt ndërtimor) është ndërtuar dhe regjistruar vetëm në emër të subjektit dhe vëllait të tij B.B dhe jo sipas deklaratimit të subjektit.

<sup>24</sup> a) Sipas deklaratës “Para fillimit të detyrës 2013”, subjekti deklaroi shtëpi banimi 3 kate me sip. 145 m<sup>2</sup> x 3, e ndërtuar në bashkëpronësi me vëllain në vitin 1996 me të ardhurat e siguruar nga shitja e apartamenteve të mëparshme në Bajram Curri dhe Lushnjë, si dhe të ardhurat e vëllait si emigrant në Itali. Vlera: 8.000.000 lekë. Pjesa takuese: 50%.

b) Sipas vetëdeklarimit për legalizim të objektit “banesë”, vit ndërtimi 5.10.1998, me vendndodhje në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë. Sipërfaqe e zënë 663 m<sup>2</sup>, sipërfaqe e ndërtimit 150 m<sup>2</sup>, numri i kateve mbi tokë 3. Aplikimi është bërë nga Bajram Breçani dhe B.B.

c) Sipas deklaratës *Vetting*, subjekti deklaroi se blerja e truallit dhe ndërtimi i objektit të mësipërm është bërë nga të tre vëllezërit, Bajram Breçani, A.B dhe B.U.B, ku shtetasi A.B ka investuar shumën 2.000.000 lekë, B.B shumën 3.000.000 lekë dhe Bajram Breçani shumën 3.000.000 lekë. Vlera e truallit 460.000 lekë dhe vlera e investuar në objekt 8.000.000 lekë në total, pjesa takuese 1/3.

- d. Subjekti ka bërë ndërtim pa leje dhe zënie trualli në periudhën kur ushtronte detyrën si prokuror i Republikës së Shqipërisë.
- e. Subjekti ka pamundësi financiare për investimin mbi pasurinë e paluajtshme në vlerën 4.655.292 lekë.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

#### **1.27 Në përgjigje të rezultateve të hetimit<sup>25</sup>, në mënyrë të përmbledhur, subjekti deklaroi se:**

*“Tokën e kemi blerë unë dhe vëllai im B.B. Vëllai tjetër A.B na ka kërkuar që të ndërtonte një kat edhe ai në objektin që ne po ndërtonim dhe ne kemi rënë dakord që ta lejojmë të ndërtojë katin e tretë të objektit.*

*Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Tiranë, ka kthyer përgjigje se sipas konstatimit gjatë verifikimit në terren nga ana e punonjësve të ALUIZNI-t, objekti posedohej nga Bajram Breçani, B.B dhe A.B.*

*Problemi i bashkëpronësisë së truallit me qëllim përfshirjen e vëllait tonë A.B nuk është zgjidhur akoma përfundimisht nga ana jonë, për shkak të neglizhencës në zgjidhjen e këtij problemi, duke qenë se është një marrëdhënie në mes vëllezërish dhe nuk e kemi konsideruar problem dhe për shkak të angazhimeve të ndryshme.*

*Objekti është ndërtuar pa leje dhe është në proces legalizimi. Punimet në objekt nuk janë kryer me kompani ndërtimi, por me punëtorë dhe shpesh herë kemi punuar ne si familjarë. I vetmi dokumentacion ligjor provues në lidhje me vlerën e kësaj pasurie është një aktekspertimi i hartuar nga ana e ekspertës së vlerësimit të pasurive të paluajtshme.*

*Në lidhje me konkluzionin se subjekti ka pamundësi financiare për investimin mbi pasurinë e paluajtshme në vlerën 4.655.292 lekë, sqaroj se jo vetëm që kjo diferencë nuk është negative, por në fakt është pozitive. Vlera e objektit nuk është realisht vlera e përlllogaritur nga ana juaj, po ashtu edhe pjesa takuese e objektit e cila nuk është 50%, por 33%.*

*Në analizë financiare nuk janë marrë parasysh të ardhurat e mia gjatë kësaj periudhe dhe shpenzimet e arredimit dhe mirëmbajtjes nuk janë të periudhës në fjalë, por janë bërë vite më vonë.*

*Gjithashtu, në analizën financiare të hartuar nga ana juaj janë futur gabimisht shuma prej 2.500.000 lekësh si shpenzime arredimi dhe punime të brendshme në këtë periudhë.*

*Nga ana juaj nuk janë mbajtur parasysh të ardhurat e përfituara nga fondacioni ‘\*\*\*’ sipas mandateve të depozituara nga ana ime, të ardhura të cilat tashmë janë të konfirmuara me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14. 7.2022, së Ministrisë së Financave”.*

---

<sup>25</sup>Shihni përgjigjen e subjektit mbi rezultatet e hetimit.



## Vlerësimi i Komisionit

**1.28** Subjekti nuk arriti të provojë dhe të kundërshtojë plotësisht barrën e provës që Komisioni i kaloi në përfundim të rezultateve të hetimit për këtë pasuri.

**1.29** Komisioni vlerëson se qëndrimet dhe prapësimet e subjektit, janë në kuadrin deklarativ dhe nuk shoqërohen me dokumentacion ligjor provues.

**1.30** Pasuria truall rezultoi se është regjistruar në emër të 2 bashkëpronarëve, pra në emër të subjektit të rivlerësimit dhe vëllait të tij B.B, përkatësisht në ½ pjesë. Bazuar në kartelën e pasurisë lëshuar nga ASHK-ja, këta dy individë rezultojnë edhe sot bashkëpronarë të pasurisë “ndërtesë” me sipërfaqe totale 671.2 m<sup>2</sup> truall dhe 150.5 m<sup>2</sup> ndërtesë.

**1.31** Subjekti nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor përfshirjen e vëllait tjetër A.B dhe kontributin e tij si bashkëpronar në pasurinë truall dhe objekt. Subjekti nuk paraqiti asnjë dokumentacion provues dhe nuk rezultoi që të ishte ndërmarrë ndonjë veprim ligjor për përfshirjen e vëllait A.B në procesin e legalizimit dhe regjistrimit më pas të kësaj pasurie pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Subjekti nuk ka kryer asnjë veprim sipas pretendimit të tij për ndarjen e pasurisë në emër të tre bashkëpronarëve që nga momenti i krijimit të pasurisë dhe as që nga deklarata *Vetting* (vitit 2017) deri më sot.

**1.32** Në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2013, paraqitur përpara ILDKPKI-së, si dhe në kërkesën e bërë për legalizim pranë ALUIZNI-t, subjekti nuk e ka deklaruar faktin dhe përfshirjen e vëllait A.B si përfitues dhe kontribuues në blerjen e pasurisë truall dhe ndërtimin e objektit si bashkëfinancues (për rrjedhojë edhe si bashkëpronar). Subjekti ka deklaruar se ka bërë deklaram të pasaktë të kësaj pasurie në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2013 pranë ILDKPKI-së.

**1.33** Subjekti nuk arriti të provojë kontributin e vëllait A.B për blerjen dhe ndërtimin e objektit dhe as mundësinë financiare të tij. Deklarata se shtetasi A.B ka qenë posedues i katit të tretë të pasurisë bie në kundërshtim me deklaramet e subjektit. Sipas përgjigjes së subjektit në pyetësin nr. 2 është deklaruar se z. A.B <sup>26</sup> ka banuar dhe banon në qytetin e Bajram Currit dhe kati i tretë i objektit, për të cilin ai mund të këtë kontribuar, është i pabanueshëm.

**1.34** Komisioni arriti në përfundimin se vlera e investimit për këtë pasuri (objekt ndërtimor) do të konsiderohet sa 50% (1/2 bashkëpronësi) e vlerës së deklaruar prej subjektit në deklaratën *Vetting* (edhe në deklaratën para fillimit të detyrës). Vlera e investimit total në objektin ndërtimor të deklaruar në deklaratën e pasurisë është 8.000.000 lekë, ku pjesa takuese e subjektit u llogarit nga Komisioni (1/2 pjesë) në vlerën 4.000.000 lekë.

**1.35** Subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me koston e ndërtimit. Raporti i ekspertit të paraqitur nga subjekti nuk përbën provë për përcaktimin e koston së ndërtimit<sup>27</sup>. Raporti i ekspertit i kontraktuar (aktekspertimi i njëanshëm) nga

<sup>26</sup>Gjithashtu, subjekti përcjell edhe kontratën e blerjes së apartamentit në vitin 2005 prej Entit Kombëtar të Banesave nga shtetasi A.B, në qytetin e Tropojës (dosja ILDKPKI, f. \*\*\*).

<sup>27</sup>Shihni vendimin nr. 15, datë 17.7.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

subjekti nuk paraqet situatën reale të ndërtimit në ato vite për vetë faktin se ky raport është hartuar në vitin 2022 dhe ekspertja nuk ka qenë në gjendje të konstatojë situatën ndërtimore reale në ato vite. Në vlerësimin teknik ekspertja si vlerësuese e pasurisë së paluajtshme shkon përtej misionit të saj duke bërë edhe vlerësim juridik dhe duke përcaktuar ndarjen e pasurisë objekt ndërtimor për tre bashkëpronarë dhe jo dy, siç përcaktohet në dokumentacionin e pronësisë për këtë pasuri.

**1.36** Shpenzimet e arredimit, mobilimit dhe përshtatjes, Komisioni i vlerësoi në përputhje me deklaratën *Vetting* të bërë nga subjekti i rivlerësimit në shumën 2.500.000 lekë. Në lidhje me periudhën e investimit/blerjes së tyre, duke u nisur nga deklarimi në deklaratën *Vetting* të subjektit, për përdorimin e kredisë së marrë nga NOA për punime të brendshme dhe arredim banese dhe në harmoi me shpjegimet e provat e dhëna gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioni mori në konsideratë deklarimin e subjektit bërë në pyetësonin nr. 2<sup>28</sup>.

**1.37** Në përfundim, pas përgjigjes së subjektit dhe vlerësimit të provave, Komisioni hartoi analizën financiare për subjektin Bajram Breçani si në vijim.

### 1.38 Analiza financiare

	Vlera në lekë
<b>Investimi i subjektit</b>	<b>5 384 000</b>
Blerja e truallit	184 000
Vlera e ndërtimit të 50% të objektit sipas deklarimit të subjektit në <i>Vetting</i>	4 000 000
Shpenzime arredimi dhe punimet e brendshme deri në vitin 1998 sipas pyetësonit nr. 2.	1 200 000
<b>Burimi</b>	<b>3 450 200</b>
Të ardhura nga shitja e banesës në qytetin e Lushnjës, sipas aktmarrëveshjes datë 12.3.1997	1 500 000
Vlera e të ardhurave nga shitja e banesës në rrugën “***”, Tiranë datë 16.1.1997, pasi është zbritur vlera e huas kthyer vëllait (149.800 lekë)	850 200
Hua e marrë prej vëllait B. B e kthyer në vitin 2003, deklaruar në deklaratën <i>Vetting</i>	600 000
Të ardhura nga mandatpagesa nr. ***, datë 20.7.1996, nga fondacioni “Xh	500 000
Të ardhura të tjera nga paga ndër vite ose kursime	
<b>Rezultati</b>	<b>- 1 933 800</b>

**1.39** Në analizën përfundimtare Komisioni mori në konsideratë të ardhurat e subjektit të përfituara nga fondacioni “\*\*\*” në shumat 500.000 lekë dhe 825.000 lekë.

**1.40** Vlera e investimit është konsideruar sa gjysma e vlerës së ndërtimit total të objektit, të deklaruar në deklaratën *Vetting*, prej 4.000.000 lekësh.

<sup>28</sup>Shihni përgjigjen e pyetësonit nr. 2 të bërë nga subjekti në dosjen e Komisionit.

**1.41** Vlera e shpenzimeve të punimeve të brendshme, arredimit dhe përshtatjes janë përfshirë në analizën financiare sipas shpjegimeve të dhëna në pyetësorin nr. 2<sup>29</sup>, ku rezulton se deri në vitin 1998 vlera e investimeve të tjera (përshtatje, arredim dhe punime të brendshme) është 1.200.000 lekë.

**1.42** Ndërsa në lidhje me shpjegimet e dhëna prej subjektit të rivlerësimit gjatë procesit se, si burim kanë shërbyer edhe kursimet ndër vite, nuk janë përfshirë në analizën financiare pasi nuk janë deklaruar si të tilla në deklaratën *Vetting*, por edhe duke iu referuar analizës financiare<sup>30</sup> të viteve 1995 – 1998 rezulton me pamundësi financiare duke mos pasur mundësi kursimi.

**1.43** Trupi gjykues, bazuar sa më sipër, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë në deklaratën *Vetting* dhe është munduar të pasqyrojë fakte të pavërteta lidhur me koston e ndërtimit dhe personat e përfshirë në blerjen e pasurisë truall dhe ndërtimin e objektit.

**1.44** Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë, të pamjaftueshëm dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e pasurisë truall dhe ndërtimin e objektit (pjesën takuese), duke mos u gjendur në kushtet e përcaktuara në germën “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016. Gjithashtu, subjekti është gjendur në kushtet e përcaktuara nga germa “b”, e pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016 për shkak të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për këtë pasuri.

## **2. Automjet**

**2.1** Subjekti ka deklaruar: *“Blerje automjeti me kontratë noteriale nr. \*\*\* rep., datë 27.10.2003, në vlerën 200.000 lekë. Burimi i të ardhurave: kursimet. Ky automjet është shitur në datën 1.3.2009 me kontratë noteriale nr. \*\*\*, në shumën 430.000 lekë”*.

**2.2** Për të provuar pretendimet e tij, subjekti ka paraqitur:

Dosjen e mjetit, lëshuar nga DPSHTRR-ja, e cila përmban:

- lejen e qarkullimit të automjetit, me targa TR \*\*\*, në emër të shtetasit A. D;
- vërtetim nga Komisariati i Policisë Nr.\*\*\*, për humbje targe të automjetit nga shtetasi A. D.;
- kontratë akt shitblerje pasuri e luajtshme, nr. \*\*\*, datë 1.3.2009, nënshkruar ndërmjet palës shitëse Bajram Breçani dhe palë blerëse A.D, të automjetit lloji “\*\*\*”, targa TR\*\*\* . Vlera e shitjes së automjetit 430.000 lekë, shumë e cila është likuiduar jashtë zyrës noteriale;
- kontratë shitblerjeje nr. \*\*\* rep., datë 27.10.2003, nënshkruar ndërmjet palës shitëse I.B dhe palës blerëse Bajram Breçani, të automjetit “\*\*\*”, kundrejt çmimit 200.000 lekë, shumë e cila është likuiduar nga blerësi jashtë zyrës noteriale;

<sup>29</sup>Përgjigjja nr. 2, pyetësori nr. 2 *“Shpenzimet e ndara ndër vite janë si më poshtë: në vitin 1996 rreth 1.100.000 lekë; në vitin 1997 rreth 2.500.000 lekë; në vitin 1998 rreth 600.000 lekë dhe në vitin 2005 rreth 1.000.000 lekë”*.

<sup>30</sup>Shihni analizën financiare në faqen 33 të këtij vendimi.

- certifikata e pronësisë së mjetit rrugor “\*\*\*\*”, me targa TR \*\*\* , në emër të shtetasit A.D.;
- certifikata e kontrollit fizik të automjetit, datë 5.3.2009;
- certifikatë personale e shtetasit A.D.;
- certifikata e kontrollit fizik të automjetit, datë 27.10.2003;
- certifikatë personale e shtetasit Bajram Breçani; si dhe
- dokumentacioni i blerjes dhe zhdoganimit të automjetit nga shtetasi I.B.

**2.3** DPSHTRR-ja, me shkresat nr. \*\*\* prot., datë 25.7.2017 dhe datë 27.9.2017,<sup>31</sup> nuk konfirmon automjet të regjistruar në emër të subjektit Bajram Breçani.

**2.4** Këtë pasuri automjet, subjekti nuk e dispononte në kohën e plotësimit të deklaratës *Vetting*, pasi është shitur në vitin 2009.

**2.5** Në lidhje me konkluzionin e Komisionit se blerja e pasurisë në shumën 200.000 lekë në vitin 2003 dhe shitja, më pas, në vitin 2009, në vlerën 430.000 lekë (trajtuar në pikën 3 në vijim të vendimit), duket se nuk pasqyron situatën reale dhe nuk i përgjigjet ekonomisë së tregut.

**2.6** Subjektit, për gjetjen e konstatuar dhe mundësinë financiare për blerjen e kësaj pasurie, iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe paraqitur provat për të provuar të kundërtën e konkluzionit të bërë nga Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

**2.7** Subjekti, në shpjegimet përfundimtare të tij, ka deklaruar se ka kryer shpenzime riparimi dhe mirëmbajtje, të cilat nuk i mban mend si vlerë dhe nuk ka mbajtur dokumentacion, pasi nuk ka qenë subjekt deklarues në kohën e blerjes dhe shitjes dhe për shkak të kohës së gjatë të veprimeve.

**2.8 Në përfundim, Komisioni arriti në përfundimin se nuk provohet ligjshmëria e të ardhurave nga shitja (pagesa e tatimit si e ardhur personale) dhe nuk provohen/as deklarohet vlera e shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe riparimit.**

### **3. Automjet**

**3.1** Subjekti ka deklaruar blerje automjeti me kontratën noteriale nr. \*\*\*, datë 14.4.2009, në vlerën 9.000 euro. Burimi i të ardhurave nga kredia e marrë te NOA dhe të ardhura nga shitja e automjetit më 1.3.2009.

**3.2** Për të provuar deklarinimin e tij, subjekti ka paraqitur: vërtetimi i lëshuar nga NOA, datë 20.1.2017, për kredinë e marrë më 9.4.2009, në vlerën 972.320 lekë.

**3.3** Dosja e këtij automjeti të lëshuar nga DPSHTRR-ja përmban dokumentacionin ligjor<sup>32</sup>.

<sup>31</sup>Shihni shkresat e dërguara nga DPSHTRR-ja në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>32</sup>*Certifikata e pronësisë së mjetit rrugor “\*\*\*\*”, me targa TR \*\*\* , në emër të Bajram Breçani. Pronësia mbi mjetin është fituar nëpërmjet aktit \*\*\* datë 14.4.2009; certifikata e kontrollit fizik të automjetit, datë 16.4.2009; certifikatë lindje e shtetasit Bajram Breçani; kontratë shitje nr. \*\*\* , datë 14.4.2009, e automjetit “\*\*\*\*”, vit prodhimi 1998. Palë blerëse Bajram Breçani dhe palë shitëse N.Ll. Vlera e blerjes së automjetit 9.000 euro, është likuiduar jashtë zyrës noteriale; si dhe dokumentacioni ligjor i automjetit në pronësi të N. Ll, blerë në Gjermani në vlerën 2.300 euro.*

**3.4** Rezultoi se ky automjet është shitur para deklaratës *Vetting* me kontratë shitblerje nr. \*\*\*, datë 15.4.2015, nënshkruar ndërmjet palës shitëse Bajram Breçani dhe palës blerëse E.D të automjetit tip “\*\*\*”, vit prodhimi 1998, targa TR \*\*\* . Vlera e shitjes së automjetit 2.500 euro është likuiduar nga blerësi jashtë zyrës noteriale.

**3.5** DPSHTRR-ja, me shkresat nr. \*\*\* prot., datë 25.7.2017 dhe datë 27.9.2017<sup>33</sup>, nuk konfirmon automjet të regjistruar në emër të subjektit Bajram Breçani.

**3.6** Lidhur me burimin e krijimit të automjetit, subjekti deklaroi se ka përdorur kredinë e marrë pranë NOA dhe të ardhurat nga shitja e automjetit me targa TR \*\*\* . Nga shkresa e përcjellë në Komision nga NOA<sup>34</sup> sh. a. rezulton se në datën 9.4.2009, subjektit të rivlerësimit i është disbursuar kredi me vlerë 972.230 lekë. “Intesa Sanpaolo Bank<sup>35</sup>” informon se në datën 10.4.2009 në llogarinë e subjektit të rivlerësimit është transferuar vlera 535.836 lekë, e cila është tërhequr *cash* prej tij në datën 14.4.2009, ditën e nënshkrimit të kontratës së shitjes së automjetit.

**3.7** Komisioni kërkoi shpjegime mbi këtë shumë të transferuar dhe mënyrën e përdorimit të saj, për të cilat subjekti sqaroi se<sup>36</sup>: “Kjo shumë është depozituar në llogarinë time si rezultat i disbursimit të kredisë prej 972.320 lekësh, sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 9.4.2009, lidhur ndërmjet meje dhe NOA sh.a. Kjo shumë është përdorur për blerje makine nga ana ime ndërsa pjesa tjetër prej 436.484 lekësh për shlyerjen e kredisë së marrë më parë pranë NOA. Për blerjen e makinës përveç kësaj shume kanë shërbyer edhe shuma 430.000 lekë përfituar nga shitja e makinës tip ‘\*\*\*’, në vlerën 430.000 lekë dhe pjesa tjetër është mbuluar nga kursimet që kisha *cash*”.

**3.8** Bazuar në të dhënat e dërguara nga DPSHTRR-ja<sup>37</sup> rezultoi se të ardhurat nga shitja e automjetit me targa TR \*\*\* në datë 1.3.2009, janë me vlerën 430.000 lekë. Por ky automjet rezultoi i blerë në vitin 2003, në vlerën prej 200.000 lekë, pra, më pak se vlera e shitjes së tij (blerë 6 vjet para shijes).

**3.9** Komisioni hartoi analizën e burimit të krijimit të pasurisë mbështetur në deklarinimin e subjektit në deklaratën *Vetting*,<sup>38</sup> e cila është si në vijim.

Burimi i financimit		Vlera e blerjes së automjetit (vlerat/lekë)
Kredia pranë Noa sh. a.	535, 836	1,234,530

<sup>33</sup>Shihni përgjigjet e DPSHTRR-së në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>34</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 12.8.2020.

<sup>35</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 3.7.2020, nga “Intesa Sanpaolo Bank”, këtu është bërë transferimi i shumës së kredisë, pasi NOA nuk ka sistem të saj.

<sup>36</sup>Bashkëlidhur me pyetësorin shkresa nr. \*\*\* prot., datë 6.5.2022, nga NOA, kopje të kontratës së kredisë, urdhrin e disbursimit të saj dhe kopje të kontratave të automjeteve, të cilat provojnë shpjegimet e tij.

<sup>37</sup>Shkresat nr. \*\*\* prot., datë 25.7.2017 dhe datë 27.9.2017, dosja ILDKPKI-së.

<sup>38</sup>Subjekti në deklaratën *Vetting* deklaroi si burim vlerën e shitjes së automjetit TR \*\*\* dhe kredinë e marrë pranë NOA sh a. Ndërsa gjatë shpjegimeve të dhëna në pyetësor nr. 2, shpjegon se si burim përveç sa më lart, kanë shërbyer edhe kursimet e tij *cash*.

Vlera e shitjes së automjetit me targa TR ***	200,000	
<b>Totali</b>	35,836	1,234,530
<b>Diferenca ose pamundësia financiare</b>		<b>(-498,694)</b>

**3.10** Në analizë financiare nuk është përfshirë e gjithë vlera prej 430.000 lekësh e deklaruar nga subjekti si e ardhur nga shitja e automjetit tip “\*\*\*”. Automjetin në fjalë subjekti e ka deklaruar të blerë në vitin 2003 në shumën prej 200.000 lekësh dhe shitur, më pas, në vitin 2009, në vlerën 430.000 lekë. Për këtë diferencë nga blerja në shitje (e cila nuk përkon as me logjikën e ekonomisë së tregut) nuk janë paguar detyrimet tatimore (nuk janë paguar të ardhurat e tatueshme në burim mbi çmimin e blerjes).

**3.11** Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të provuar kundërtën e rezultateve të hetimit, duke dhënë argumente e paraqitur prova, për të provuar mundësinë financiare që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë automjet.

**3.12** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka deklaruar se: *“Automjeti është shitur në shumën 430.000 lekë dhe jo 200.000 lekë siç është llogaritur nga ana juaj. Për shkak të shpenzimeve të riparimit dhe mirëmbajtjes së tij që kur është blerë, nuk kam pasur detyrim të paguaj tatim fitimi. Gjithashtu, në analizën financiare të hartuar nga ana juaj, nuk janë marrë parasysh të ardhurat e mija nga paga pranë NOA në atë vit, si dhe në vitet e mëparshme dhe kursimet ndër vite të cilat unë nuk kam pasur detyrim ti deklaroj në atë periudhë pasi nuk kam qenë subjekt deklarimi. Për blerjen e automjetit kam pasur të ardhura të mjaftueshme nga paga që më kanë krijuar mundësi kursimi”*.

**3.13** Subjekti, në vijim të shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit, ka paraqitur edhe një analizë financiare hartuar nga ana e tij, lidhur me mundësinë për kursim deri në datën 14.4.2009, duke e konsideruar me bilanc pozitiv.

### **Vlerësimi i Komisionit**

**3.14** Komisioni ka kryer analizën e burimit të krijimit të pasurisë mbështetur në deklarinimin e subjektit të rivlerësimit, pikërisht, në deklaratën *Vetting*, ku deklaroi se: Burimi i të ardhurave për blerjen e automjetit janë: nga kredia e marrë në NOA dhe të ardhura nga shitja e makinës në datën 1.3.2009. Gjatë procesit të hetimit, si në pyetësorin nr. 2 dhe në shpjegimet përfundimtare, subjekti ndryshoi burimin dhe shton si burim krijimi “kursimet e tij nga pagat”.

**3.15** Komisioni nuk mori parasysh analizën financiare të subjektit, burimin nga pagat e pretenduara pranë NOA, pasi nuk është deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting*. Komisioni mori të ligjshme vlerën prej 200.000 lekësh nga shitja e automjetit “\*\*\*”, në vitin 2009, si dhe të ardhurat nga kredia e marrë në NOA, nga ku rezultoi me pamundësi financiare në vlerën 498,694 lekë.

**3.16 Për sa më sipër, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e konkluzionit të Komisionit, si dhe nuk provoi me burime të ligjshme blerjen e automjetit, sipas përcaktimeve të germës “b”, të nenit 33/5, të ligjit nr. 84/2016.**

**4. Në lidhje me deklarin e vajzës së subjektit D.B,** Komisioni, pas analizimit të dy llogarive të saj bankare të deklaruara në lekë dhe në euro, nuk gjeti problematika.

**5. Në lidhje me deklarin e djalit të subjektit A.B,** Komisioni hetoi mbi pasurinë e tij “automjet”, deklaruar e dhuruar nga shtetasi A. S. H (kunati i motrës D.B), me kontratë noterie dhurimi më 13.2.2014. Pjesa takuese: 100%. Ky automjet është deklaruar si pasuri në përdorim nga fundi i vitit 2010 dhe në datën 16.8.2011 është bërë një kontratë përdorimi noteriale, gjë që vërteton përdorimin deri në momentin e dhurimit.

**5.1** Rezultoi se me anë të kontratës së përdorimit nr. \*\*\*, datë 16.8.2011, nënshkruar ndërmjet pronarit A.H dhe përdoruesit A.B, automjeti jepet në përdorim me afat të papërcaktuar, duke filluar nga data 16.8.2011.

**5.2** Ky automjet, më pas, i është dhuruar djalit të subjektit me kontratën e dhurimit të automjetit me nr. \*\*\*, datë 13.2.2014, me palë dhurues të mjetit A. H dhe palë pranuese e dhuratës A. B. Me anë të deklaratës së datës 26.1.2017 A.H, sqaron lidhur me automjetin e dhuruar prej tij shtetasit A.B<sup>39</sup>.

**5.3** DPSHTRR-ja, me shkresat nr. \*\*\* prot., datë 25.7.2017 dhe datë 27.9.2017 dhe nr. \*\*\* prot., datë 9.7.2020, konfirmon automjet të regjistruar në emër të A.B me targa AA\*\*\*.

**5.4** Nga Komisioni, në referencë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit iu la barrë prove, ku bazuar në pikën 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, subjekti duhet të provojë burimin e ligjshëm dhe mundësitë financiare të dhuruesit për blerjen e kësaj pasurie (pasuri e cila i është dhuruar djalit të subjektit të rivlerësimit në vitin 2014).

**5.5** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti përveç dokumentacionit të përcjellë me deklaratën *Vetting*, bashkëlidhur shpjegimeve sjell edhe deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 19.7.2022, të dhuruesit A.H, si dhe deklarinet në tatime të tij në shtetin italian, ku ky i fundit ishte administrator i shoqërisë “\*\*\*\*”, e cila rezulton me një bilanc fitimi prej 19.000 euro, në vit.

**5.6** Komisioni mori në konsideratë deklaratën noteriale të hartuar prej shtetasit A.H (e cila ishte përcjellë në *Vetting*) dhe deklarinet në agjencinë e të ardhurave në shtetin italian për aktivitetin tregtar të zhvilluar atje për periudhën 2008, ku fitimi i deklaruar është 19.912 euro.

**5.7 Në përfundim, Komisioni arriti në përfundimin se personi dhurues A. H kishte mundësi financiare për dhurimin e kësaj pasurie, djalit të subjektit A. B.**

**6.** Komisioni hetoi në lidhje me automjetin e blerë nga djali i subjektit më 27.4.2015, me kontratën nr. \*\*\*, në vlerën 450.000 lekë. Pjesa takuese: 100%. Burimi i këtyre të

---

<sup>39</sup>Shihni deklaratën e dhuruesit A. H të datës 26.1.2017, në praktikën e DPSHTRR-së, për këtë automjet, si dhe dosjen e automjetit.

ardhurave është nga shitja e automjetit të babait, sipas kontratës së datës 15.4.2015, në vlerën 2.500 euro dhe një pjesë nga kursimet.

**6.1** Rezultoi se kjo pasuri është blerë me kontratë shitje automjeti nr. \*\*\*, datë 27.4.2015, nënshkruar ndërmjet palës shitëse A. K dhe palës blerëse A. B. Automjeti është tip “\*\*\*\*”, vit prodhimi 2004. Vlera e blerjes së automjetit rezultoi 450.000 lekë.

**6.2** DPSHTRR-ja, me shkresat nr. \*\*\* prot., datë 25.7.2017 dhe datë 27.9.2017 dhe nr. \*\*\* prot., datë 9.7.2020, konfirmon automjet të regjistruar<sup>40</sup> në emër të A.B me targa AA \*\*\*.

**6.3** Komisioni hartoi analizën financiare, mbi burimin e krijimit të pasurisë mbështetur në deklarin e subjektit në deklaratën *Vetting*, si në vijim.

<b>Analiza financiare</b>	<b>1.1.2015-27.4.2015 (vlerat/lekë)</b>
Të ardhurat nga paga pranë shoqërisë “****” sh.p.k. <sup>41</sup>	184,784
Të ardhura nga shitja e automjetit në pronësi të subjektit të rivlerësimit me targë TR ***	0 (zero) <sup>42</sup>
Vlera e blerjes së automjetit prej z. A. B	450,000
Ndryshimi i gjendjes së likuiditeteve në bankë	-2,413
Shpenzimet jetike për një anëtar	56,069
<b>Rezultati financiar</b>	<b>-318,872</b>

**6.4** Nga analiza financiare rezultoi se djali i subjektit nuk ka pasur mundësi financiare për blerjen e automjetit, duke rezultuar me vlerë negative prej 318,872 lekësh.

**6.5** Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të provuar burimin e ligjshëm për këtë pasuri.

**6.6** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka sjellë një version të tij të analizës financiare për blerjen e automjetit nga djali i tij me të ardhura nga paga, për periudhën 1.11.2011 – 27.4.2015, ku rezultati është pozitiv në shumën 2.607.928 lekë. Në këtë analizë është përfshirë edhe vlera e automjetit me targa TR \*\*\*, të cilën Komisioni nuk e kishte përfshirë në analizën e rezultateve, pasi nuk provohej burimi i ligjshëm i krijimit (trajtuar më lart, automjet i subjektit).

**6.7** Ndërsa, në lidhje me të ardhurat nga paga dhe shpërblimet e djalit nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., në analizën e subjektit janë përfshirë në vlerën 3.39.650 lekë, për periudhën 1.11.2011 – 27.4.2015, sipas dy vërtetimeve nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., bashkëlidhur shpjegimeve përfundimtare të lëshuara më 17.5.2022. Në vërtetimin e lëshuar nga kjo shoqëri për shpërblimet e përfituara nga djali i subjektit, deklarohet se tatimi është mbajtur

<sup>40</sup>Shihni dosjen e automjetit me targa AA \*\*\*, lëshuar nga DPSHTRR-ja.

<sup>41</sup>Këtu nuk janë përfshirë shpërblimet ose bonuset e përfituara prej tij nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., pasi nuk është konfirmuar nga DPT-ja dhe ISSH-ja pagesa e tatimit mbi të ardhurat për këto vlera.

<sup>42</sup>Nuk janë përfshirë në analizën financiare të ardhurat nga shitja e automjetit me targa TR \*\*\*.



në burim, ndërsa vlerat konfirmohem nga transaksionet bankare të tij në BKT, ku janë derdhur vlerat e tyre.

**6.8** Në përfundim, në analizë edhe të përgjigjes së rezultateve të hetimit bërë nga subjekti, Komisioni përfshiu vlerën e pagave të konfirmuara nga shkresat e DPT-së dhe ISSH-së, ndërsa në lidhje me shpërblimet ato duhet të ishin të konfirmuara edhe nga DPT-ja. Megjithatë, edhe në rast të kundërt (të vërtetimit nga DPT), këto vlera shpërblimesh janë përfituar në vitin 2013 dhe 2014, ndërsa automjeti është blerë në vitin 2015. Gjithashtu, nuk janë deklaruar vlerë kursimesh *cash* nga ana e djalit të subjektit, i cili kishte detyrimin për deklarim në DIPP-në e vitit 2014 e vijim, si person i lidhur (në një certifikatë familjare me subjektin) dhe, për këtë arsye, Komisioni, pas përgjigjeve të rezultateve të hetimit, hartoi analizën financiare vetëm më të ardhurat e tij prej janarit të vitit 2015 e deri në datën e blerjes së automjetit, ku rezultati financiar është negativ në vlerën prej 318.872 lekësh.

**6.9** Për sa më sipër, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e konkluzionit të Komisionit, si dhe nuk provoi me burime të ligjshme blerjen e automjetit, sipas përcaktimeve të germës “b”, të nenit 33/5, të ligjit nr. 84/2016.

## **7. Transfertë bankare në emër të djalit të subjektit/A. B**

**7.1** Djali i subjekti ka deklaruar se: *“Në datën 20.10.2009 miku im A.A.K, i datëlindjes 20.3.1989, lindur në Përmet, Shqipëri, ka bërë një derdhje në llogarinë time personale që e hapa me kërkesën e tij me qëllim për ta ndihmuar në transfertën që do të kryente për menaxheren e tij R.B.Zh, në Kinë. Transferta ishte në shumën 25.060 USD. Theksoj që, miku im A.A.K kishte një biznes familjar në fushën e importit të suvenireve dhe artistikeve. Ky biznes menaxhohej nga A dhe mamaja e tij R.K. Transferta që është bërë nga A.K në llogarinë time dhe nga llogaritmë të znj. R.B.Zh kishte për qëllim shlyerjen e një detyrimi që A.A.K kishte ndaj saj. R.B.Zh ishte menaxhere që kujdesej për blerjen dhe transportin e mallit nga Kina për në Shqipëri për llogari te A.A.K. Këto transaksione janë kryer në datën 20.10.2009 në ‘ProCredit Bank’, afër \*\*\*, kohë në të cilën babai im nuk ishte subjekt deklarimi pranë institucionit tuaj. Po ju vë në dispozicion mandatet dhe transfertën, si dhe burimin e të ardhurave të z. A.K për shumën në fjalë”.*

**7.2** Për këtë veprim rezulton një deklaratë (me shkrim dore, jo ligjore nga forma), lëshuar nga shtetasi A.A.K, ku sqaron në lidhje me transfertën e kryer nga llogaria personale e A.B, në vlerën 25.060 USD.

**7.3** Për veprimet e kryera nga djali i subjektit rezultoi:

- Urdhër transfertë në “ProCredit Bank”, datë 20.10.2009, të shumës 25.000 USD nga llogaria e A.B në favor të R.B.Zh, me përshkrimin “detyrim personal”.
- Mandat i konvertimit (lekë-USD) dhe depozitimit *cash* të shumës 25.060 USD, pranë “ProCredit Bank” në datën 20.10.2009, nga A.K në llogarinë bankare të A.B Përshkrim veprimi “depozitim A.K, të ardhura personale” (paraqitur dokumentacioni në origjinal dhe në fotokopje).

- Kontratë kredie bankare, nënshkruar në datën 21.8.2009, në “ProCredit Bank”, nga kredimarrësi “\*\*\*\*” sh.p.k. (përfaqësuar nga R.K), palë debitor solidar R.K, A.K dhe N.K. Vlera e kredisë 3.000.000 lekë, afat shlyerje 36 muaj. Në aneksin 2 të kontratës ndodhen lista e objekteve të vendosura garanci për kredinë e akorduar.
- Ekstrakt i regjistrimit në QKB të aktivitetit tregtar “\*\*\*\*” sh.p.k., regjistruar më 9.11.2007, me NIPT \*\*\*, me përfaqësues ligjor shtetasin A.K dhe ortakë 100% shtetasin R.K. Objekt aktiviteti “tregti me shumicë e pakicë të artikujve të ndryshëm”. Status aktiviteti “pezulluar”. Data e lëshimit të ekstraktit më 10.9.2013.

**7.4** “ProCredit Bank”, me shkresën nr. \*\*\*, datë 26.7.2017<sup>43</sup>, konfirmon llogari rrjedhëse (USD) në emër të shtetasit A.B, çelur më 20.10.2009 dhe mbyllur më 10.4.2011.

**7.5** Subjekti ka paraqitur dokumentacion justifikues për transfertën e kryer dhe burimin e krijimit të fondeve, për llogari të shtetasit A.K, por, gjithsesi, në përfundim të hetimeve, Komisioni i kërkoi subjektit të deklarojë se cila është marrëdhënia e djalit të tij me këtë shtetas dhe pse është bërë ky veprim nga djali i tij i cili nuk ushtronte as aktivitet tregtar.

**7.6** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti shpjegoi se marrëdhënia e djalit të tij me këtë shtetas është marrëdhënie miqësie dhe e ka kryer për ta ndihmuar shokun e tij. Subjekti sjell deklaratë noteriale të lëshuar në Angli, nga deklaruesi A.K ku deklaroi se me A.B kanë qenë shokë prej universitetit dhe vazhdon t’i mbajë këto marrëdhënie. Po ashtu, ka deklaruar se i ka kërkuar shokut të tij për lehtësi dhe shpejtësi veprimesh ndihmë për të kryer transfertën me furnitorin e biznesit të tij. Bashkëlidhur sjell ekstrakt QKB-je të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., ku është aksioner me 100%. Gjithashtu, bashkë me shpjegimet, subjekti sjell edhe deklaratë nga shtetasi A.B, nënshkruar në SHBA përpara noterit publik, ku deklaroi sa më sipër shpjeguar.

**7.7** Ndodhur në këto kushte, Komisioni vlerësoi shpjegimet e subjektit bindëse dhe të mbështetura në dokumentacion ligjor.

**8. Në lidhje me deklarimin e vajzës së subjektit D.B,** Komisioni hetoi për:

- aksione 6% pranë shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.<sup>44</sup>;
- automjet në pronësi me vlerë 3.000 euro. Pjesa takuese: 100%;
- aksione 5% në shoqëritë “\*\*\*\*” sh.a.<sup>45</sup> dhe “\*\*\*\*” sh.p.k.;
- gjendje llogarie bankare<sup>46</sup>.

**8.1** Në përfundim të hetimit nuk u konstatuan problematika lidhur me deklaratimet e saj dhe llogaritë bankare (bashkë me lëvizjet e vërtetuara).

<sup>43</sup>Shihni shkresën e “ProCredit Bank”, në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>44</sup>Shihni shkresën e QKB-së në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>45</sup>Shihni dokumentacionet në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>46</sup>Shihni shkresat e bankave në dosjen e ILDKPKI-së.

## **9. Aksione në shoqëri të vajzës së subjektit D.B**

**9.1** Komisioni hetoi, gjithashtu edhe për aksione në shoqëri të vajzës së subjektit D.B, e cila ka deklaruar se: *“Jam aksionere me 5% të aksioneve të shoqërisë ‘\*\*\*’ sh.a. me NIPT \*\*\*. Vlera: 100.000 lekë. Pjesa takuese: 5%”*.

**9.2** Në deklaratën *Vetting* vajza e subjektit D.B ka shpjeguar historikun e shitblerjeve të aksioneve<sup>47</sup>, ku në fund ka mbajtur vetëm 5% të aksioneve. *Të gjitha transaksionet janë bërë cash (para në dorë) dhe janë kryer në periudhën që babai nuk ka qenë subjekt deklarimi.*

**9.3** ILDKPKI-ja ka konstatuar: *Në deklaratat e interesave private në ILDKPKI, vajza e subjektit D.B nuk ka deklaruar 5% të aksioneve të zotëruara prej saj në shoqërinë ‘\*\*\*’ sh. a. Deklaron për herë të parë në deklaratën *Vetting*.*

**9.4** QKB-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.8.2017<sup>48</sup>, konfirmon se shtetasja D.B figuron Anëtare e Këshillit Mbikëqyrës dhe aksionere me 5% të kuotave në shoqërinë ‘\*\*\*’ sh. a., me NIPT \*\*\*.

**9.5** Bashkia Tiranë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 24.7.2017, konfirmon se shtetasja D.B është anëtare këshilli/ortake në shoqërinë ‘\*\*\*’ sh. a. (biznes i madh), me NIPT \*\*\*, nga data 15.3.2013 e në vazhdim. Subjekti ka xhiro të deklaruar nga në vlerën 8.000.000 lekë dhe detyrime të palikuiduara në vlerën 320.859 lekë.

**9.6** DRT-ja Tiranë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 8.8.2017<sup>49</sup>, konfirmon se shtetasit O.H dhe D.B rezultojnë të jetë regjistruar si:

- Aksionerë në shoqërinë ‘\*\*\*’ sh. a., regjistruar më 22.7.2009, me NIPT \*\*\* dhe nr. kuota përkatësisht (20% - 95%) dhe (5% - 20%). Aktiviteti i shoqërisë “tregti me pakicë e karburanteve për mjetet e transportit automobilistik”. Status “pasiv”, prej datës 26.3.2017.

Shoqëria, gjatë periudhës 2009 – 2016, ka deklaruar xhiro vetëm për vitin 2010 në shumën 18.057.406 lekë dhe fitim 3.446.633 lekë. Shoqëria rezulton me detyrime në vlerën 1.192.196 lekë. Dividend 0 (zero).

**9.7** DRT-ja Tiranë, me anë të postës elektronike, datë 21.6.2019<sup>50</sup>, konfirmon se ky institucion në përgjigje të shkresës me nr. \*\*\* prot., datë 5.7.2017, ka konfirmuar tatim dividendi të paguar, konkretisht: (i) viti 2011, shuma 2.500.000 lekë, për principal dividend të shpërndarë 25.000.000 lekë; (ii) viti 2012, shuma 1.546.968 lekë, për principal dividend të shpërndarë 15.469.680 lekë; (iii) viti 2013, shuma 1.650.000 lekë për principal dividend të shpërndarë 16.500.000 lekë.

<sup>47</sup>Shihni shpjegimet e vajzës së subjektit në deklaratën *Vetting*.

<sup>48</sup>Shihni shkresën e QKB-së në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>49</sup>Shihni shkresën e DRT-së në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>50</sup>Shihni korrespondencën e DRT-së me ILDKPKI-në në dosjen e ILDKPKI-së.

**9.8** Bashkia Tiranë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 24.7.2017, konfirmon se shtetasi O.H është administrator/ortak nga data 13.9.2010 e në vazhdim në shoqërinë aksionere “\*\*\*” sh. a. (biznes i madh) me NIPT \*\*\*.

**9.9** Vajza e subjektit të rivlerësimit D.B ka blerë 20%<sup>51</sup> të aksioneve në shoqërinë “\*\*\*” sh. a. në datën 3.9.2010 dhe ka shitur 15% të tyre gjatë vitit 2011, para se subjekti i rivlerësimit të ushtronte funksionin e prokurorit. Aktualisht zotëron 5% të tyre dhe statusi i shoqërisë është pezulluar.

**9.10** Në përfundim të hetimeve, subjektit iu kërkua të paraqiste vërtetim nga prokuroritë ku ka ushtruar detyrën, ku të deklarohet se nuk ka ndjekur asnjë çështje penale ndaj z. O.H.

**9.11** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti solli vërtetimet nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe asaj Krujë, ku thuhet se *prokurori B. Breçani nuk ka ndjekur materiale kallëzuese apo procedime penale që kanë lidhje me subjektin O. H.*

**10. Për deklarimin e vajzës së subjektit A.M (B), Komisioni nuk konstatoi problematika.**

## **11 Gjendja cash**

**11.1** Subjekti deklaron në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2013: “*Gjendje cash në banesë. Të ardhura të siguruara nga puna në një program të USAID-it nga viti 2001-2010. Vlera: 3.500.000 lekë. Pjesa takuese: 50%*”.

**11.2** Në deklaratën *Vetting* nuk deklaron gjendje kursimesh *cash*. Edhe në deklaratat e interesave private periodike vjetore 2013 – 2016 nuk deklaron përdorimin ose shpenzimin e kësaj vlere.

**11.3** Sa më sipër, subjektit i janë kërkuar shpjegime<sup>52</sup> për mospërputhjen e rezultuar për të cilat sqaron: “*Në lidhje me këtë shumë, nga ana ime është bërë një lapsus gjatë plotësimit të deklaramit, pasi ka qenë hera e para që plotësoja një deklaram periodik. Shuma në fjalë ka qenë me lekë të vjetra dhe gabimisht në plotësim kam shtuar një 0 (zero), pra, nuk ka qenë 3.500.000 lekë, por ka qenë 350.000 lekë. Sa i përket gjendjes cash në çdo fund viti është ajo e deklaruar në deklaratat periodike dhe deklaratën *Vetting* dhe duke qenë se nuk i disponoj deklaratat periodike nuk mbaj mend shumat e deklaruara. Gjendja cash e pasurisë në banesë në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting* është ajo e deklaruar në këtë deklaratë”.*

**11.4** Ndërsa, në lidhje me burimin e krijimit të saj ka rezultuar se ka mospërputhje të deklaramit në deklaratën *Vetting*<sup>53</sup> me deklarimin në deklaratën para fillimit të detyrës për krijimin e gjendjes *cash* të kursimeve<sup>54</sup>, për të cilën iu kërkuan shpjegime: “*Siç ju shpjegova edhe në përgjigjen e pyetjes së mëparshme gjendja cash në banesë ka qenë në*

<sup>51</sup>Rezulton nga shkresa e DPT-së aneks \*\*\*, në dosjen ILDKPKI-së se fitimi deklaruar i shoqërisë “\*\*\*” sh.a., për vitin 2009 ka qenë në vlerën 1.287.632 lekë (sipas formularit të deklaramit të pagesës së tatim fitimit).

<sup>52</sup>Përgjigje pyetësi nr. 2.

<sup>53</sup>“*Paga nga \*\*\* (program i USAID) periudha korrik 2000 - 20.8.2001. Shuma e të ardhurave: 1.200.000 lekë.*”

<sup>54</sup>“*Të ardhura të siguruara nga puna në një program të USAID-it nga viti 2001 - 2010. Vlera: 3.500.000 lekë*”.

shumën 350.000 lekë dhe jo 3.500.000 lekë siç është deklaruar gabimisht në deklaratën para fillimit të detyrës, dhe ky ka qenë një lapsus i bërë nga ana ime për shkak të mungesës së eksperiencës në plotësimin e deklaratimit të pasurisë. Ky gabim është korrigjuar nga ana ime në plotësimin e deklaratës Vetting duke deklaruar vlerën e saktë”.

**11.5** NOA<sup>55</sup> (ish- partneri shqiptar në mikrokredi) konfirmon se ka qenë i punësuar pranë saj për periudhën 21.8.2001– 20.10.2010. Ndërsa, PMSH-ja, me vërtetimet datë 9.4.2003 dhe datë 1.3.2007, konfirmon se subjekti i rivlerësimit ka qenë i punësuar pranë tyre me pagë 100.000 lekë/muaj.

**11.6** Në lidhje me burimin e krijimit të gjendjes *cash* u hartua analiza financiare, sipas deklaratimit të bërë nga subjekti në deklaratën para fillimit të detyrës 2013, e cila është pasqyruar në vijim.

Vitet	Analiza akumulative gusht 2001- tetor 2010 (vlerat/lekë)
<b>TË ARDHURAT</b>	<b>10 028 018</b>
Të ardhurat e subjektit të rivlerësimit nga paga pranë ***	9 172 390
Të ardhurat e vajzës së subjektit D. B (gusht - dhjetor 2010), pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave	125 292
Të ardhurat nga shitja e automjetit në datën 1.3.2009 në shumën 430.000 lekë	200 000
<b>DETYRIMET</b>	<b>300 336</b>
Kredia pranë NOA (***) më 1.7.2008	- 97 824
Kredia pranë NOA (***) më 9.4.2009	398 160
<b>SHPENZIMET</b>	<b>7 971 016</b>
Kthim huaje në vitin 2003 marrë prej vëllait B. B, deklaruar në Vetting	600 000
Blerje automjeti me kontratë nr. *** rep., datë 27.10.2003, në vlerën 200.000 lekë	200 000
Blerje automjeti me targë TR ***, me kontratë nr. ***, datë 14.4.2009, në vlerën 9.000 euro	1 234 530
Ndryshimi i gjendjes së likuiditeteve në bankë	3 245
Shpenzime jetike për 6 anëtare të familjes deri në vitin 2006, më pas 5 anëtarë	5 933 241
<b>REZULTATI FINANCIAR OSE MUNDËSIA PËR TË KURSYER</b>	<b>1 827 002</b>

**11.7** Në përfundim të rezultateve të hetimit, Komisioni doli në konkluzionin se subjekti kishte pamundësi financiare për krijimin e gjendjes *cash* në shumën prej 3.500.000 lekësh të deklaruara në deklaratën para fillimit të detyrës 2013, në vlerën -1.672.998 lekë. Për këtë gjetje, subjektit iu la barrë prove bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

<sup>55</sup>Shkresë datë 19.1.2017, nga NOA, pjesë e dosjes ILDKPKI.

**11.8** Subjektit iu kërkua, gjithashtu, të japë shpjegime për mospërputhjen e rezultuar në deklaratimet e gjendjes së kursimeve *cash* në deklaratën *Vetting* (gjendja 0 lekë) me gjendjen e rezultuar nga deklaratimet vjetore në DIPP-të për vitet 2013-2016, ku gjendja e kursimeve *cash* në fund të vitit 2016 është në shumën 3.500.000 lekë.

**11.9** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti shpjegoi se vlera e deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës është deklaruar gabim dhe duhej të deklarohet 350.000 lekë nga 3.500.000 lekë. Gjithashtu, subjekti paraqiti një analizë financiare për mundësinë e krijimit të kësaj vlere, ku rezultoi se vlera totale që mund të kursente subjekti dhe familja e tij në periudhën gusht 2001 – tetor 2010 është 6.060.962 lekë. Pra, sipas tij, ka pasur mundësi për krijimin e gjendjes *cash* në shumën prej 3.500.000 lekësh.

**11.10** Ndryshimi i analizës së subjektit me atë të rezultateve të hetimit të Komisionit është në vlerën e të ardhurave nga paga e subjektit të rivlerësimit pranë NOA në vitet 2001 – 2010, ku Komisioni ka llogaritur pagën *neto* të tij të konfirmuar me vërtetim të datës 19.1.2017, nga NOA. Ndërsa, subjekti përfshin në analizë të ardhurat në vlerën 13.706.686 lekë, e cila është vlera e të ardhurave *bruto* nga paga e tij në këtë institucion.<sup>56</sup> Në metodologjinë e analizës financiare të Komisionit përfshihen të ardhura të ligjshme, pasi zbriten vlerat e detyrimeve ndaj institucioneve shtetërore.

**11.11** Komisioni vlerësoi se shpjegimet e subjektit mbi mundësinë e krijimit të kursimeve *cash* të deklaruar prej tij në deklaratën para fillimit të detyrës (2013) nuk ishin bindëse. Ndërsa, gjatë hetimit u konstatua se subjekti nuk kishte krijuar pasuri me burim kursimet *cash* të deklaruara. Si përfundim, mospërputhja e gjendjes *cash* të deklaruar në deklaratat periodike 2013 – 2016 me deklaratën *Vetting* konsiderohet pasaktësi, e cila nuk sjell pasojë përgjegjësinë administrative për subjektin e rivlerësimit në kuptim të ligjit nr. 84/2016.

## **12 Analiza financiare (periudhat gusht 1995 – maj 2000 dhe 2013 – 2016)**

**12.1** Në vijim të analizës financiare të kryer mbi pasuritë e deklaruara në deklaratën *Vetting*, si dhe në deklaratimet periodike ndër vite, duke përfshirë të gjitha të dhënat mbi të ardhurat, shpenzimet, kursimet dhe detyrimet, nga përlllogaritja e tyre është vlerësuar dhe është konkluduar mbi mjaftueshmërinë e burimeve financiare për çdo vit për të përballuar investimet, shpenzimet apo kursimet e deklaruara dhe/ose të kursyera me të ardhurat nga burime të ligjshme në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

**12.2** Komisioni hartoi analizën financiare të ndarë në dy periudha kohore në referencë të kohës gjatë të cilës subjekti i rivlerësimit ka qenë në detyrë. Periudha e parë kohore përfshin vitet 1995 deri në maj të vitit 2000. Në këtë periudhë kohore, subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Lushnjë dhe, më pas, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Krujë. Ndërsa periudha e dytë e analizës financiare i referohet viteve 2013 – 2016, në të cilën subjekti ka ushtruar detyrën e prokurorit pranë prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Pasi janë analizuar shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe provat e përcjella, rezultoi se për vitet 1995 – 2000, analiza financiare ka

<sup>56</sup>Shkresë datë 19.1.2017, nga NOA, në dosjen e ILDKPKI-së Aneks \*\*\*.

vlerë negative prej 5.829.949 lekësh, ndërsa analiza financiare për periudhën janar 2013 – 2016 rezulton me vlerë pozitive<sup>57</sup>.

**12.3** Komisioni analizoi, vlerësoi dhe mori në konsideratë qëndrimin e subjektit në harmoni me provat e administruara në dosje, duke pranuar dhe reflektuar të gjitha efektet e shpjegimeve bindëse dhe të bazuara në dokumentacion justifikues ligjor në rezultatet financiare të viteve përkatëse, të lidhura kryesisht me të ardhurat nga fondacioni “\*\*\*\*” të provuara me mandatpagesat e përcjella në Komision dhe të deklaruara në deklaratën e pasurisë; shpenzimet e ndërtimit të objektit dhe shpenzimet e përshtatjes (arredimi, punime të brendshme, etj.) të deklaruara në pyetësonin nr. 2 dhe pas përcjelljes së rezultateve të hetimit. Duke u mbështetur mbi të tilla shpjegime u arrit në konkluzionin se rezultati i analizës financiare të subjektit për periudhën 1995 – 2000 është në vlerën negative totale prej 2.449.229 lekësh.

---

<sup>57</sup>Vlera 2.905.346 lekë.

**Analiza financiare (gusht 1995 – maj 2000)**

Vitet	1995	1996	1997	1998	1999
<b>Të ARDHURAT</b>	<b>874 957 Lekë</b>	<b>946 926 Lekë</b>	<b>3 372 050 Lekë</b>	<b>417 478 Lekë</b>	<b>432 667 Lekë</b>
Të ardhura nga paga si OPGJ në Prok. Lushnje 01.11.1993-30.08.1995	127 887 Lekë				
Të ardhura nga paga në Prokurorinë Lushnje 01.09.1995-15.01.1999	71 870 Lekë	297 126 Lekë	272 050 Lekë	417 478 Lekë	28 100 Lekë
Të ardhura nga paga në Prok. Krujë 01.02.1999-12.05.2000					404 567 Lekë
Të ardhura nga shitja e banesës në Rr. ***, Tiranë dt. 16.01.1997			1 000 000 Lekë		
Të ardhura nga fondacioni Xh. të tërhequra në vitin 1995	675 200 Lekë				
Të ardhura nga mandat pagesa nr.*** dt. 20.7.1996 nga fondacioni Xh.		500 000 Lekë			
Hua marrë prej vëllait B. B. për blerjen e apartamentit në Tiranë		149 800 Lekë			
Të ardhura nga shitja e banesës në qytetin e Lushnje, sipas Akt-Marrëveshjes dt.12.3.1997			1 500 000 Lekë		
Hua e marrë prej vëllait B. B. e kthyer në vitin 2003, deklaruar në vetting			600 000 Lekë		
<b>SHPENZIMET</b>	<b>221 840 Lekë</b>	<b>2 183 803 Lekë</b>	<b>3 829 353 Lekë</b>	<b>1 059 535 Lekë</b>	<b>18 546 Lekë</b>
Blerja e apartamentit në Rr. ***, Tiranë dt. 29.01.1996		825 000 Lekë			
Blerja e apartamentit në qytetin e Lushnje me kontrate paraprake dt. 22.04.1996	90 000 Lekë	62 700 Lekë			
Blerja e truallit me kontratë dt. 16.6.1998				184 000 Lekë	
Kthimi i huasë të marrë prej vëllait B. B. për blerjen e apartamentit në Tiranë			149 800 Lekë		
Vlera e investimit në ndërtesë nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës 1996-1998 deklarates vetting dhe pyetesor nr. 2		1 100 000 Lekë	3 500 000 Lekë	600 000 Lekë	
Shpenzime jetike për 6 anëtare të familjes	131 840 Lekë	196 103 Lekë	179 553 Lekë	275 535 Lekë	18 546 Lekë
<b>Rezultati financiar</b>	<b>653 117</b>	<b>-1 236 877</b>	<b>-457 303</b>	<b>-642 057</b>	<b>414 121</b>



## Analiza financiare (për periudhën 2013 – 2016)

<i>Përshkrimi</i>	<b>2013</b>	<b>2014</b>	<b>2015</b>	<b>2016</b>
<b>PASURI</b>	<b>350 338</b>	<b>-138 920</b>	<b>209 300</b>	<b>-68 407</b>
Shtëpi banimi me sip. 145 m2 me sip. trualli 460 m2 dhe një pjesë shpati rreth 300 m2, të ndodhura në Rr. "****", Tiranë. Në bashkëpronësi me vëllezërit, pjesa takuese 33.3% .				
Automjet blerë me kontratë dt. 27.10.2003 në vlerën 200.000 lekë, shitur në dt.01.03.2009 në shumën 430.000 lekë				
Automjet me targë TR **** blerë me kontratë dt. 14.04.2009 në vlerën 9.000 euro, shitur në dt.15.04.2015, në shumën 2.500 euro. Burimi i blerjes: të ardhurat nga kredia marrë pranë NOA dhe të ardhurat nga shitja e makinës në dt.01.03.2009.			-344 125	
Automjet i dhuruar nga A. H. me kontratë dt. 13.02.2014, në përdorim nga A. B. prej 2010.				
Automjet me targë AA**** blerë me kontratë dt. 27.04.2015 në vlerën 450.000 lekë, në përdorim nga subjekti i rivlerësimit. Burimi: të ardhurat nga shitja e automjetit me kontratë dt.15.04.2015 nga sub. i rivlerësimit dhe kursimet e A. B.			450 000	
Dhënie hua L. M. nga A. B. në shumën 120.000 lekë			120 000	
Shtesa/pakësime likuiditete në bankë dhe CASH	350 338	-138 920	-16 576	-68 407
Gjendje kursimesh cash	3 500 000	3 500 000	3 500 000	3 500 000
<i>Total likuiditete</i>	3 745 550	3 606 630	3 590 054	3 521 647
<b>DETYRIME</b>	<b>0</b>	<b>-91 911</b>	<b>-10 317</b>	<b>-21 791</b>
Kredi e marrë pranë NOA me qëllim blerje automjeti në datë 09.04.2009		-208 848		
Kredi konsumatore e marrë prej A. B. dt. 28.03.2014		116 937	-10 317	-21 791
Kartë krediti pranë për D. B. shuma 20.000 lekë datë 04.12.2016				
<b>PASURI NETO</b>	<b>350 338</b>	<b>-47 008</b>	<b>219 617</b>	<b>-46 617</b>
<b>TË ARDHURA dokumentuar</b>	<b>1 853 952</b>	<b>1 576 839</b>	<b>2 078 686</b>	<b>2 165 343</b>
Të ardhura nga paga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Krujë dhe nga paga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan.	841 740	936 432	1 053 584	1 081 810
Të ardhura nga punësimi i bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit			131 065	
Të ardhura nga punësimi i vajzës D. B. për periudhën 01.01.2013 deri në 31.12.2016	552 011	145 573	374 393	716 149
Të ardhura nga punësimi i djalit A. B. për periudhën 01.01.2013 deri në 31.12.2016	460 201	494 834	479 644	333 384
Kthimi i huasë nga shtetasi L. M., djalit të subjektit A. B.			40 000	34 000
<b>SHPENZIME</b>	<b>1 230 281</b>	<b>949 037</b>	<b>1 105 658</b>	<b>1 008 169</b>
Shpenzime interesi per kredine prane Raiffeisen Bank		7 842	12 773	0
Shpenzime shkollimi të A. B. pranë Universitetit M. B.	392 588			
Shpenzime udhëtimi	273 597	61 203	195 781	48 210
Shpenzime jetese	564 096	879 992	897 104	959 959
<b>Analiza dokumentuar</b>	<b>273 333</b>	<b>674 810</b>	<b>753 411</b>	<b>1 203 791</b>

## B. KONTROLLI I FIGURËS

DSIK-ja, si institucioni kompetent për kontrollin e figurës, pas verifikimit të deklarimeve të subjektit dhe të dhënave të tjera me qëllim përcaktimin nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me krimin e organizuar, në përmbushje të ushtrimit të funksioneve sipas ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, i ndryshuar, pasi ka kryer të gjitha procedurat për kontrollin në përputhje me parashikimet e pikës 4 të nenit 4 dhe neneve 37 dhe 38 të ligjit nr. 84/2016, ka paraqitur pranë Komisionit raportin përfundimtar me nr. \*\*\* prot., datë 31.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 26.5.2022, të KDZH-së, nga ku rezulton se:

- formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në përputhje me ligjin nr. 84/2016;
- subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës;
- për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose persona të dyshuar të krimit të organizuar;
- subjekti i rivlerësimit Bajram Breçani është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

Për pastërtinë e figurës nuk ka pasur të dhëna e dyshime bazuar në raportin e DSIK-së.

Komisioni kreu një hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetit të subjektit të rivlerësimit, përfshirë edhe verifikimin e informacioneve të dërguara<sup>58</sup> nga agjencitë ligjzbatuese. Nga hetimi i kryer nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e subjektit në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në neni DH të Aneksit të Kushtetutës.

**Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Bajram Breçani ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.**

---

<sup>58</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 19.4.2022, drejtuar DSIK-së dhe raportin e deklasifikuar datë 31.5.2022, të DSIK-së.

### C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Raporti i vlerësimit profesional për subjektin Bajram Breçani, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është përgatitur nga institucionet e rivlerësimit në kuadrin e procesit të rivlerësimit kalimtar të subjekteve, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Raporti është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: formularit të vetëdeklarimit dhe dokumenteve shoqëruese; tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit; pesë dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; dhe të dhënave nga Prokuroria e Përgjithshme dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, duke iu referuar kritereve të mëposhtme të vlerësimit:

- a) aftësitë profesionale;
- b) aftësitë organizative;
- c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale;
- d) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

Për periudhën e kërkuar, subjekti i rivlerësimit Bajram Breçani ka qenë me detyrë këshilltar ligjor pranë “P.Sh.M” deri në mars të vitit 2010 dhe për periudhën mars 2010 – janar 2013 ka qenë me detyrë inspektor në Drejtorinë e Inspektimit të Prokurorisë pranë Ministrisë së Drejtësisë.

Nga janari i vitit 2013 deri në nëntor të vitit 2013 ka qenë me detyrë prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Krujë dhe më pas në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Aktualisht prokurori Bajram Breçani ushtron detyrën në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

#### **Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit**

Gjatë periudhës së vlerësimit, subjekti i rivlerësimit, prokurori Bajram Breçani, ka përzgjedhur dhe ka paraqitur tri dokumente ligjore, konkretisht:

**1. Dokumenti ligjor:** konkluzione përfundimtare në gjykimin e çështjes penale me të pandehur B.K, akuzuar për kryerjen e veprës penale “vrasje me dashje”, parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal dhe I.S, akuzuar për veprën penale “përkrahje e autorit të krimit”, parashikuar nga neni 302 i Kodit Penal, paraqitur në gjykatë në datën 15.4.2015.

**2. Dokumenti ligjor:** vendim nr. \*\*\* “Për pushimin e procedimit penal”, regjistruar në datën 12.1.2015 për veprat penale “plagosja e rëndë” kryer në bashkëpunim, “kanosje” parashikuar përkatësisht nga nenet 88-25 dhe 84 të Kodit Penal.

**3. Dokumenti ligjor:** kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. \*\*\* të vitit 2016, për veprën penale “vjedhje me dhunë” mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 139 dhe 22 të Kodit Penal, në ngarkim të të pandehurit B.M.

## **Përshkrimi i pesë dosjeve për prokurorin Bajram Breçani, të përzgjedhura me short**

**Dosja 1** – kallëzimi penal nr. \*\*\*, datë regjistrimi 29.4.2016, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan

### *Rrethanat e çështjes*

Në datën 27.4.2016 shtetasi Gj. X është paraqitur në Komisarjatin e Policisë Cërrik dhe ka kallëzuar largimin e vajzës së tij të quajtur R, e vitlindjes 1998. Kallëzuesi ka shpjeguar se vajza ishte larguar nga banesa një ditë më parë dhe nuk kishin informacion për vendndodhjen e saj. Kallëzuesi dyshonte se vajza mund të ishte larguar për në shtetin grek së bashku me një person të quajtur A. M. Shtetasi Gj.X, gjithashtu, ka shfaqur dyshime edhe për ndonjë trafikim të mundshëm të vajzës nga ana e shtetasit të lartpërmendur.

Menjëherë pas marrjes së kallëzimit policia gjyqësore ka pyetur me cilësinë e deklaruës shtetasin N.M, babai i A. Në deklarimin e tij, ky shtetas ka shpjeguar se sapo ishte kontaktuar nga kallëzuesi, komunikoi nëpërmjet telefonit me të birin A, i cili i kishte thënë se ndodhej së bashku me R.X në Greqi. Referuar A, motivi pse ata me vullnet të përbashkët kishin zgjedhur këtë mënyrë për t'u larguar kishte të bënte me faktin se familja e R nuk do ta pranonte lidhjen e tyre. Në rrethanat kur ata kishin një marrëdhënie serioze, të cilën do të dëshironin ta finalizonin me martesë, kishin vendosur të bashkëjetonin në shtetin grek.

Pas administrimit të materialit kallëzues, sa më sipër nga ana e prokurorit është vlerësuar se ekzistojnë rrethana që nuk lejojnë fillimin e procedimit, duke argumentuar se:

- Nga materiali i administruar nuk rezulton të jenë konsumuar ndonjë prej elementeve të veprës penale të parashikuar nga neni 114/b, paragrafi 1 i Kodit Penal, apo të ndonjë vepre tjetër penale. Prokurori vijon në arsyetimin e tij se *që të kemi elemente të anës objektive të veprës penale kërkohet që veprimet e kryera të jenë në format e rekrutimit, rrëmbimit, transportimit, shtrëngimit, kanosjes, të cilët në rastin konkret nuk janë ekzistente*. Sa i përket anës subjektive të kësaj vepre penale, konkretisht qëllimi i shprehur në disa drejtime që ka të bëjë me shfrytëzimin seksual, prokurori ka vlerësuar se nuk janë të pranishme.
- Rrjedhimisht, duhet që të plotësohen në mënyrë kumulative të gjithë elementet objektivë dhe subjektivë të marra së bashku të veprës penale, të parashikuar nga ligji penal, që të flitet në këtë mënyrë për marrje të personit në përgjegjësi penale.

Për sa më lart, prokurori Bajram Breçani, duke u bazuar në germën “ç” të nenit 290 dhe nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur “Mosfillimin e procedimit penal lidhur me kallëzimin penal nr. \*\*\*, datë 9.5.2016”.

Komisioni konstatoi se subjekti nuk ka kryer asnjë veprim hetimor për të konkluduar nëse është konsumuar ndonjë element i veprës penale, por është bazuar vetëm në praktikën e referuar nga Komisarjati i Policisë Cërrik. Subjekti është mjaftuar vetëm me procesverbalet e mbajtura para regjistrimit të materialit për veprën penale dhe vetëm në deklarimin e të

atit të personit, ndaj të cilit i ishte referuar kallëzimi penal, pa kryer veprime të tjera hetimore dhe procedurale për të verifikuar të paktën vendndodhjen e personave dhe pa kontaktuar me denoncuesin apo vajzën e tij.

Për këtë subjektit iu kërkua të japë shpjegime në rezultatet e hetimit.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti paraqiti arsyet që kanë çuar në vendimin e mosfillimit të hetimeve, ku bëhet fjalë për një kallëzim të babait që kishte të bënte me largimin e të bijës, i cili dyshonte se vajza mund të ishte larguar për në shtetin grek së bashku me një person të quajtur A. M. (për ndonjë trafikim të mundshëm të vajzës nga ana e shtetasit të lartpërmendur). Por, pasi personat ishin ballafaquar dhe sqaruar situatën se vajza ishte larguar me dëshirën e vullnetin e saj, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit, nuk kishte regjistruar kallëzimin në kuadrin e një procedimi penal.

**Dosja 2** – procedimi penal nr. \*\*\*, datë regjistrimi 16.11.2015, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan

#### *Rrethanat e çështjes*

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan, mbi bazën e materialeve referuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan, regjistroi procedimin penal për veprën penale “trafikim i mjeteve motorike”, parashikuar nga neni 141/a i Kodit Penal.

Konkretisht, nga verifikimet e kryera ka rezultuar se automjeti tip “\*\*\*\*”, me targa EL \*\*\*, në pronësi të shtetasit N.B, ishte i denoncuar si i vjedhur në Bosnjë-Hercegovinë. Pyetur për faktin, shtetasi N.B ka shpjeguar se automjetin e kishte blerë para një muaji nga një shtetas i quajtur A.P dhe kur ka shkuar në DRSHTRR-në Fier për të kryer procedurat e ndërrimit të pronësisë i kanë bërë me dije se kishte disa parregullsi në lejen e qarkullimit, por që janë zgjidhur pas kontrollit fizik të automjetit. Shtetasi A.P është pyetur nga policia gjyqësore, i cili ka deklaruar se automjetin në fjalë e kishte blerë në vitin 2006 në Elbasan nga një person i quajtur P.T. Në funksion të hetimit është realizuar akti teknik i shasisë prej nga është konkluduar se në automjetin objekt hetimi ka pasur ndërhyrje që konsistojnë në ndryshimin e numrave të shasisë.

Në kuadër të hetimit është sekuestruar edhe dokumentacioni i automjetit, pjesë e të cilit ka qenë edhe leja e hyrjes dhe qarkullimit provizor, lëshuar në datën 13.1.2015, në emër të një shtetasi serb të quajtur E.M dhe pasi ka ndërruar disa herë pronësinë i është sekuestruar shtetasit N.B. Shtetasi serb, pasi ka hyrë me automjet në territorin shqiptar, ia ka shitur shtetasit S.V dhe ky i fundit, një ditë pasi është bërë pronar i automjetit, ia ka shitur një personi tjetër.

Hetimi i kësaj çështjeje ka përfshirë edhe verifikimet përkatëse në disa degë të doganave, konkretisht Elbasan dhe Tiranë. Nga përgjigjet e administruara evidentohet se automjeti nuk rezultoi i regjistruar në asnjë pikë të kalimit kufitar, ndërkohë procedura e zhdoganimit të automjetit është realizuar sipas ligjit në qytetin e Elbasanit.

Prokurori Bajram Breçani, pasi ka vlerësuar se veprimet hetimore ishin kryer të plota, analizon se nuk është bërë i mundur identifikimi, zbulimi dhe gjetja e autorit të kryerjes së veprës penale “trafikim i mjeteve motorike”, parashikuar nga neni 141/a i Kodit Penal. Referuar dokumentacionit shoqërues të automjetit në fjalë nuk mund të vërtetohet dhe provohet koha e saktë e hyrjes së automjetit në territorin shqiptar. Verifikime janë kryer edhe sa i përket hyrje-daljeve në pikat e kalimit kufitar të shtetasit S.V, por nuk ka rezultuar që të ketë pasur të tilla në periudhën që ka përbërë interes për hetimin.

Prokurori argumenton se dispozita e veprës penale “trafikim i mjeteve motorike”, parashikuar nga neni 141/a i Kodit Penal, përcakton se: *“Importimi, eksportimi, tranzitimi dhe tregtimi në kundërshtim me ligjin i mjeteve motorike, të vjedhura me qëllim përfitimi material ose çdo përfitimi tjetër, dënohet me burgim në maksimum 7 vjet burgim”*.

Referuar hetimit ka qenë fakt i provuar se automjeti i është nënshtruar regjimit doganor në datën 12.1.2005, ndërkohë, prej atij momenti deri në kohën kur prokurori ka disponuar me vendim kishin kaluar 11 vjet.

Në këto kushte, prokurori çmon se në bazë të nenit 66 të Kodit Penal hetimet për veprën penale për të cilën ishte regjistruar procedimi penal nuk mund të vazhdonin, pasi vepra penale ishte parashkruar.

Të njëjtin argument prokurori Bajram Breçani ka përdorur edhe sa i përket veprave penale të parashikuara nga neni 190 i Kodit Penal.

Në datën 19.9.2016 subjekti i rivlerësimit Bajram Breçani ka përpiluar “Vendimin për pushimin e çështjes”, në mbështetje të germave “d” dhe “f”, të pikës 1, të nenit 328, të Kodit të Procedurës Penale dhe ka vendosur “Të pushojë çështjen penale nr. \*\*\* të vitit 2015, për veprën penale ‘trafikim i mjeteve motorike’, parashikuar nga neni 141/a i Kodit Penal”.

**Dosja 3** – procedimi penal nr. \*\*\*, datë regjistrimi 1.4.2014, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan

#### *Rrethanat e çështjes*

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, mbi bazën e referimit penal të policisë gjyqësore, ka bërë regjistrimin e procedimit penal nr. \*\*\* për veprën penale “kanosje”, parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal.

Konkretisht, në datën 17.3.2014 kallëzuesi H.H, teksa lëvizte me automjetin e tij i është ndërprerë rruga nga shtetasi R.U, i cili me një gur ka goditur xhamin e automjetit. Pas këtij veprimi shtetasi R.U me një sforc të cilin e mbante në dorë e ka sulmuar me qëllim për ta goditur, por pa mundur për shkak se H është larguar.

Sa ka rezultuar, shkak i konfliktit midis shtetasve R.U dhe H.H ishte një sipërfaqe toke e ndodhur në fshatin \*\*\* në pronësi të shtetasit H.H. Shtetasi R.U pretendonte se sipërfaqja

e tokës i përkiste atij dhe dokumentet e pronësisë së shtetasit H.H ishin realizuar nëpërmjet falsifikimit.

Në funksion të hetimit është kryer këqyrja fizike e shtetasit H.H, prej nga është evidentuar grisja e mëngës së xhaketës si pasojë e goditjes me gur. I pyetur për rrethanat që i atribuoheshin, shtetasi R.U ka deklaruar se ai vërtet është ndodhur në vendin prej nga ka kaluar kallëzuesi me automjet, por mohon ta ketë goditur me gur apo ta ketë kanosur me mjete të tjera.

Prokurori Bajram Breçani, pasi ka vlerësuar se veprimet hetimore kanë qenë të plota, në analizën e tij konkludon se nuk provohet që shtetasi R.U të ketë kanosur shtetasin H.H. Prokurori e mbështet argumentin e tij me faktin se të dy shtetasit japin versione të kundërta mbi ngjarjen, ndërkohë nuk ka asnjë dëshmitar okular që të ketë parë ngjarjen dhe të deklarojë se si ka ndodhur në të vërtetë.

Në datën 30.12.2014 subjekti i rivlerësimit Bajram Breçani ka përpiluar “Vendimin për pushimin e çështjes”, në mbështetje të gremës “b”, të pikës 1, të nenit 328, të Kodit të Procedurës Penale dhe ka vendosur:

- Të pushojë procedimin penal nr. \*\*\* të vitit 2014.
- Vendimi t’u njoftohet të interesuarve.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan ose tek prokurori më i lartë.

Në bazën ligjore të identifikuar nga prokurori Bajram Breçani (neni 328, pika 1, germa “b”), e cila parashikon pushimin e çështjes ose të akuzës në rastin kur “fakti nuk parashikohet nga ligji si veprë penale”, ka lapsus. Në aktin vendim pushimi argumentohet se nuk provohet se personi nën hetim të ketë kryer veprën penale për të cilën është regjistruar procedimi penal. Në rastin konkret duhet të ishte vendosur si bazë ligjore neni 328, pika 1, germa “dh”, e cila parashikon pushimin e çështjes ose të akuzës në rastin kur *nuk provohet se i pandehuri e ka kryer veprën penale.*

Sa vërehet nga momenti i regjistrimit si procedim penal deri në disponimin me vendim pushimi ka kaluar një kohë e gjatë, rreth 9 muaj. Konstatohet se prokurori Bajram Breçani, pas regjistrimit si procedim penal, ka urdhëruar policinë gjyqësore për kryerjen e veprimeve hetimore me afat të përcaktuar. Rezulton se veprimtaria hetimore e policisë gjyqësore është shtrirë në një periudhë 9-mujore. Konkretisht, në periudhën maj – qershor policia gjyqësore ka realizuar marrjen e deklarimeve të tri shtetasve dhe në muajin dhjetor të dy të tjerëve. Referuar akteve të fashikullit në harkun kohor të 5 muajve nuk rezulton të jetë kryer ndonjë veprim hetimor.

Nga vërtetimi, datë 30.9.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan rezulton se nuk ka pasur ankim për vendimin e pushimit.

Komisioni konstatoi se aktet procedurale të subjektit shfaqin të meta lidhur me datat për regjistrimin e procedimit penal dhe delegimin e veprimeve hetimore. Subjekti duket se ka zgjatur hetimet për këtë çështje 9 muaj dhe gjatë kësaj periudhe nuk rezulton të jenë kryer veprime plota procedurale hetimore për përcaktimin e faktit dhe veprës penale. Duket se nuk disponohet vendim për zgjatje afati të hetimit. Vendimi i pushimit të procedimit penal nga prokurori është bërë në kundërshtim me sugjerimin e oficerit të policisë gjyqësore, i cili ka sugjeruar që kjo çështje të kalojë për gjykim në gjykatë për veprën penale “kanosje” dhe duket se nuk është marrë në konsideratë edhe fakti se shtetasi i akuzuar ka pasur edhe më parë konflikt të vazhdueshëm me denoncuesin për motive pronësie.

Për këtë subjektin iu kërkua të japë shpjegime në rezultatet e hetimit.

Në lidhje me këtë kërkesë të Komisionit, në përgjigje të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, subjekti paraqiti argumente se pavarësisht burimit nga kishte ardhur kallëzimi dhe sugjerimit të oficerit të policisë gjyqësore, ai kishte vendosur pushimin e procedimit penal referuar faktit të vetëm, thënieve dhe dëshmime të kallëzuesit. Nga pyetja dhe ballafaqimi ai nuk kishte konkluduar në formulimin e veprës penale “kanosje”, për shkak se mungonin elemente të kësaj vepre penale. Pas komunikimit të këtij vendimi pushimi, kallëzuesi nuk ka ushtruar të drejtën e ankimit.

**Dosja 4** – procedimi penal nr. \*\*\*, datë 11.2.2014, regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për veprën penale “drejtim i automjetit në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal në ngarkim të të pandehurit F.C

#### *Rrethanat e çështjes*

Në datën 10.2.2014 shërbimet e policisë së qarkullimit rrugor të Komisarariatit të Policisë Elbasan kanë ndaluar shtetasin F.C, i cili drejtonte motomjetin tip “\*\*\*\*” dyvendësh me fushë kilometrike 140 km/h. Shërbimet policore i kanë kërkuar këtij shtetasi lejen e drejtimit, por ai ka deklaruar se nuk dispononte të tillë.

Në këto rrethana është bërë arrestimi në flagrancë i këtij shtetasi, në bazë të nenit 251/2 të Kodit të Procedurës Penale. Në kuadër të hetimeve është administruar shkresa e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor Elbasan, me anë të së cilës vërtetohet se shtetasi F.C nuk ishte i pajisur me dëshminë e aftësisë për drejtim motomjeti.

Prokurori Bajram Breçani, në çmim të të dhënave të grumbulluara bazuar në nenin 34 të Kodit të Procedurës Penale, ka konkluduar në vendimmarrjen “Për marrjen e personit të pandehur dhe njoftimin e akuzës”. Me këtë akt shtetasi F.C është marrë i pandehur për veprën penale “drejtim i automjetit në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal. Vendimi “Për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës” është përpiluar sipas standardit të akteve të kësaj natyre. Dokumenti është përpiluar sipas kërkesave të nenit 34 të Kodit të Procedurës Penale, duke treguar të dhënat e mjaftueshme



për marrjen e personit si të pandehur. Vendimi i është njoftuar të pandehurit. Në akt figuron data e njoftimit sipas parashikimeve ligjore.

Dokumenti “kërkesë” përmban të dhënat dhe elementet e kërkuara nga Kodi i Procedurës Penale. Nga përmbajtja e aktit të mësipërm konstatohet se janë respektuar rregullat e drejtshkrimit, fjalitë paraqiten të qarta dhe përmbajnë referenca ligjore. Dokumenti paraqitet i strukturuar në mënyrë të rregullt, paragrafët janë të ndarë nga njëri-tjetri, teksti paraqitet i kuptueshëm. Kërkesa, sa edhe vërehet, është nënshkruar nga i pandehuri në përputhje me pikën 2, të nenit 331, të Kodit të Procedurës Penale.

Sa rezulton, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. \*\*\*, datë 10.4.2014, ka vendosur: “Deklarimin fajtor të të pandehurit F.C, për kryerjen e veprës penale ‘drejtim i automjetit në mënyrë të parregullt’, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 muaj burgim. Në zbatim të nenit 63 të Kodit Penal pezullimin e dënimit me burgim dhe zëvendësimin me detyrimin që i pandehuri të përmbushë punë në interes publik (sipas kërkesës të organit të akuzës)”.

**Dosja 5** – procedimi penal nr. \*\*\*, datë 21.7.2015, regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për veprën penale “vjedhje e energjisë elektrike ose impulseve telefonike”, parashikuar nga neni 137/1 i Kodit Penal në ngarkim të të pandehurit S.N

#### *Rrethanat e çështjes*

Në datën 20.7.2015 punonjësit e OSHEE-së Elbasan, teksa ushtronin kontrollin e aparateve matëse të energjisë elektrike në një pallat, kanë konstatuar se njëri prej tyre kishte të prerë neutrin. Sa rezultoi, abonenti S.N brenda ambienteve të banesës kishte vendosur një çelës me anë të të cilit komandonte matësin e në këtë mënyrë nuk faturohej për energjinë që konsumonte. Në funksion të hetimit kanë dhënë shpjegimet përkatëse punonjësit e grupit të punës së OSHEE-së. Shtetasit, me cilësinë e personave që tregojnë rrethana të hetimit, kanë evidentuar mënyrën se si abonenti kishte realizuar skemën nëpërmjet të cilës vidhte energjinë elektrike.

Prokurori Bajram Breçani, në çmim të të dhënave të grumbulluara gjatë hetimit paraprak, bazuar në nenin 34 të Kodit të Procedurës Penale, ka konkluduar në vendimmarrjen “Për marrjen e personit të pandehur dhe njoftimin e akuzës”. Me këtë akt shtetasi S.N është marrë i pandehur për veprën penale “vjedhje e energjisë elektrike ose impulseve telefonike”, parashikuar nga neni 137/1 i Kodit Penal, akuzë të cilën e ka pranuar. I pandehuri ka konfirmuar qëllimin e kryerjes së veprës penale “vjedhje e energjisë”, duke e argumentuar me gjendjen e vështirë ekonomike.

Vendimi “Për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës” është përpiluar sipas standardit të akteve të kësaj natyre. Dokumenti është përpiluar sipas kërkesave të nenit 34 të Kodit të Procedurës Penale, duke treguar të dhënat e mjaftueshme për marrjen

e personit si të pandehur. Vendimi i është njoftuar të pandehurit. Në akt figuron data e njoftimit sipas parashikimeve ligjore.

Organi procedues ka vënë në dispozicion të të pandehurit aktet në ngarkim të tij, dokumentuar me procesverbalin “Për njohjen e të pandehurit me aktet”.

Mbështetur në nenin 327/2 të Kodit të Procedurës Penale, prokurori Bajram Breçani ka marrë vendim për dërgimin e çështjes në gjyq, pasi është siguruar për pyetjen e të pandehurit dhe njohjen e tij me materialet e çështjes.

Në mbështetje të nenit 331 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti i rivlerësimit ka përpiluar kërkesën për gjykimin e çështjes ndaj të pandehurit S.N, i akuzuar për veprën penale “vjedhje e energjisë elektrike ose e impulseve telefonike”, parashikuar nga neni 137/1 i Kodit Penal.

Sa rezulton, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. \*\*\*, datë 28.1.2016, ka vendosur “Deklarimin fajtor të të pandehurit S.N, për kryerjen e veprës penale ‘vjedhje e energjisë elektrike’, parashikuar nga neni 137/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 muaj burgim. Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal pezullimin e dënimit me burgim dhe vendosjen në provë për një periudhë 18 muaj (sipas kërkesës së organit të akuzës)”.

### **Të dhënat arkivore lidhur me masa disiplinore, ankesa dhe vlerësime**

Nga verifikimi i ushtruar në regjistrat e kallëzimeve dhe procedimeve penale të Prokurorisë së Përgjithshme rezulton se për prokurorin Bajram Breçani nuk kanë rezultuar të dhëna apo *indicie* të ardhura nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshime, në kuptimin penal dhe atë të cenimit të figurës së subjektit të rivlerësimit për përfshirje drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta.

Nga verifikimi i të dhënave nga burimet arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme rezulton se:

- Pas propozimit të Prokurorit të Përgjithshëm për shkarkimin nga detyra e prokurorit, Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. \*\*\*, datë 12.5.2000, ka vendosur shkarkimin e z. Bajram Breçani si prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Krujë.

Motivacioni sa më lart ka qenë për shkelje të rënda të procedurave ligjore në hetim dhe zbatim të gabuar të ligjit në hetimin e dy procedimeve penale.

Në janar të vitit 2013, bazuar në vendimin nr. \*\*\*, datë 1.11.2011, të Gjykatës së Apelit, prokurori Bajram Breçani është rikthyer në pozicionin e mëparshëm si prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Krujë.

Nga kontrolli i ushtruar në regjistrat e ankesave në Prokurorinë e Përgjithshme rezulton se është bërë një kallëzim penal, sa më poshtë vijon:

**1.** Praktika nr. \*\*\* e vitit 2020, regjistruar pas kallëzimit së shtetasës M.B, drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm, ndaj prokurorit Bajram Breçani

Shtetasja M.B në kallëzimin e saj evidenton se në datën 30.1.2019 në qytetin e Tiranës është vrarë me armë zjarri bashkëshorti i saj, shtetasi A.B. Çështja në fjalë iu ngarkua prokurorit Bajram Breçani. Kallëzuesja pretendon se *si pasojë e hetimeve të paplota, jo profesionale dhe në kundërshtim me ligjin procedural penal nga ana e prokurorit dhe gjykatës, autorit të dyshuar të krimit i është ndryshuar masa e sigurimit nga “arrest në burg” në “detyrim paraqitje”, në këtë mënyrë duke u lënë i lirë.*

Prokuroria e Përgjithshme, nëpërmjet shkresës nr. \*\*\* prot., datë 10.9.2020, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe kallëzueses M.B, ka konkluduar se bazuar në nenet 76, 78, 277 dhe 283 të Kodit Procedurës Penale kallëzimi i shtetasës i dërgohet për kompetencë dhe zgjidhje ligjore Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**2.** Mbi bazën e kërkesës për informacion, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 20.9.2020, ka bërë me dije se për subjektin e rivlerësimit Bajram Breçani, prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton të jetë regjistruar kallëzimi penal nr. \*\*\*, për veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Kallëzuesja, sa vërehet, është shtetasja M.B, e cila me të njëjtin objekt ka bërë kallëzimin e trajtuar më lart.

Në datën 28.4.2020 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal.

**3.** Mbi bazën e kërkesës për informacion, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.10.2020, bën me dije se ndaj shtetasit Bajram Breçani nuk rezulton të jetë regjistruar aktualisht ndonjë procedim penal.

**4.** Mbi bazën e kërkesës për informacion, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.4.2022, ka bërë me dije se për subjektin e rivlerësimit Bajram Breçani, prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton të jenë regjistruar tri kallëzime penale mbi bazën e kallëzimeve të bëra nga shtetasja M.B, për të cilat është vendosur mosfillimi i procedimit penal.

Çështjet lidhur me shtetasen M.B janë trajtuar në vijim të këtij vendimi, te rubrika “Denoncimet”.

**5.** Nga analiza e tri dokumenteve ligjore të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të shortuara rezulton se prokurori Bajram Breçani, sa i përket periudhës së rivlerësimit, shfaq aftësi në drejtim të zbatimit të ligjit. Nga dosjet e vëzhguara konstatohet se ka të qartë drejtimin e hetimit që do të kryejë në rastin konkret. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se ai identifikon saktë normën ligjore të zbatueshme.

Nga analiza dhe vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të shortuara evidentohet se subjekti i rivlerësimit Bajram Breçani shfaq aftësi në arsyetim ligjor. Tregon vëmendje që aktet e përgatitura prej tij të paraqiten të strukturuar me një gjuhë të kuptueshme.

Subjekti i rivlerësimit Bajram Breçani ka ushtruar kompetencat që ligji i njej prokurorit, në drejtim të ushtrimit të ndjekjes penale, kontrollit dhe mbikëqyrjes së policisë gjyqësore. Prokurori ka kryer detyrat e tij në pajtim me pikat 2 dhe 2.1 të Urdhrit nr. \*\*\*, datë 9.5.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për unifikimin e ushtrimit të funksioneve në Prokuroritë e shkallës së parë”, që përcakton se vendimi i mosfillimit të procedimit, vendimi i pushimit të çështjes, kërkesa për caktimin e masës së sigurimit personal, vendimi i zgjatjes së afatit të hetimeve, kërkesa për gjykimin e çështjes, konkluzionet përfundimtare dhe urdhrat në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale formulohen, arsyetohen dhe nënshkruhen nga prokurori i çështjes dhe detyrimin e prokurorit të çështjes për të diskutuar paraprakisht me Drejtuesin e Prokurorisë. Subjekti i rivlerësimit Bajram Breçani ka ushtruar ndjekje penale në një sërë materialesh hetimore. Nga analiza e pesë çështjeve të përzgjedhura me short, qëndrimi i tij është brenda afateve, sipas kërkesave të ligjit procedural penal. Analiza e të dhënave është bërë në referencë të ligjit procedural penal, Kushtetutës dhe jurisprudencës së Gjykatës së Lartë, të cilat vendosin detyrimin për respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. Lidhur me efektivitetin në aspektin sasior në raport me kohëzgjatjen e trajtimit të çështjeve dhe kërkesave të ndryshme penale, prokurori subjekt rivlerësi, ka përballuar ngarkesën e punës me efikasitet.

## DENONCIMET

Për subjektin e rivlerësimit janë paraqitur 12 denoncime nga 3 denoncues, nga të cilat 10 denoncime janë nga shtetasja M.B.

### **1. Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 18.1.2018, i shtetases R.H.A**

Kjo shtetase ankohet për shumë subjekte, ndër to edhe për subjektin e rivlerësimit Bajram Breçani. Ajo denoncon gjyqtarët dhe prokurorët e çështjeve të saj për arsye *se kanë dhënë vendime në shkelje të ligjit përkatës. Nuk kanë marrë për bazë dokumentacionin që ka dorëzuar, si dhe nuk kanë kryer procedurën e rregullt duke shpërdoruar detyrën...*

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, bashkëlidhur formularit të denoncimit nga publiku, konstatohet se nuk ka vend për hetim të mëtejshëm në adresë të subjektit të rivlerësimit.

### **2. Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 15.10.2018, i shtetasit S.M**

Ky shtetas i drejtohet Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, pasi sipas tij *Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk merr parasysh çështjen e tij që nga viti 2001 e deri tani. Ndërsa në lidhje me subjektin, ashtu siç vërehet edhe nga dokumentacioni bashkëlidhur ankimit, ai ka vendosur “Mosfillimin e procedimit penal në lidhje me materialet e ardhura nga Drejtoria Gjyqësore pranë Prokurorisë së Përgjithshme, që lidhet me ankimin e*

shtetasit S.M”, për të cilin ankohet dhe kërkon të kryhen veprime hetimore nga prokurori Bajram Breçani.

Subjektit iu kërkuar të japë shpjegime lidhur me kryerjen e veprimeve hetimore, afatet e procedimit penal dhe të paraqesë një kopje të praktikës së ndjekur për këtë çështje.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit në lidhje me këtë denoncim të shtetasit S M, subjekti, pasi vuri në dispozicion fashikullin e hetimit për këtë procedim penal, ku deklaroi se, pavarësisht veprimeve hetimore të kryera, ai ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për shkak se faktet e pretenduara nga kallëzuesi nuk përmbanin elemente të veprës penale. Gjithashtu, vlen të theksohet se vendimi i mosfillimit, pasi i është komunikuar kallëzuesit, ky i fundit nuk ka ushtruar të drejtën e ankimit.

### **3. Denoncim i përsëritur i shtetasës M.B:**

- kërkesë/ankesë nr. \*\*\*, datë 24.1.2020;
- kërkesë/ankesë nr. \*\*\* prot., datë 5.2.2020;
- kërkesë/ankesë nr. \*\*\* prot., datë 19.2.2020;
- memo nr. \*\*\* prot., datë 8.6.2020;
- kallëzim penal nr. \*\*\* prot., datë 24.6.2020;
- letër e hapur nr. \*\*\* prot., datë 3.8.2020;
- kërkesë nr. \*\*\* prot., datë 5.8.2020;
- letër e hapur nr. \*\*\* prot., datë 21.8.2020;
- memo nr. \*\*\* prot., datë 11.12.2020;
- ankim nr. \*\*\* prot., datë 14.9.2021, nëpërmjet të cilave ajo kërkon/ankohet/u drejtohet me letër të hapur shumë institucioneve dhe instancave të larta shtetërore dhe ndërkombëtare në lidhje me vrasjen kriminale të bashkëshortit të saj A. B. në janar të vitit 2019. Bashkëshortja e viktimës, krahas subjektit të rivlerësimit, denoncon edhe shumë subjekte të tjerë, gjyqtarë të gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të apelit.

Dokumentacioni për këtë çështje është administruar nga denoncuesja dhe materiali i paraqitur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

#### *Rrethanat e çështjes*

Në datën 30.1.2019 është vrarë me armë zjarri në një rrugë të Tiranës shtetasi A.B. Për këtë ngjarje Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka nisur hetimet dhe në datën 2.2.2019, në vendin e quajtur “\*\*\*”, B, Tiranë është gjetur automjeti me targa AA...., ku nga këqyrja e tij janë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale disa objekte, nga të cilat janë përfituar katër profile gjenetike, nga ku janë kryer aktekspertime për këto 4 profile gjenetike nga Instituti i Mjekësisë Ligjore dhe gjurmëve papilare të automjetit, të cilat i janë dërguar ZQK Interpol Tirana për t’u identifikuar dhe krahasuar. Janë dërguar shkresa kompanive celulare për logimet që janë bërë në vendin ku ka ndodhur ngjarja. Sipas aktekspertimit biologjik krahasues nr. \*\*\*..., datë 30.5.2019, është arritur në konkluzionin se “...mostra biologjike ekzaminuar në analizën e ADN-së përgatitur nga kampioni i

*pështymës objekt ekspertimi marrë shtetasit GJ.C u përfitua një profil gjenetik i seksit mashkull me cilësitë dhe karakteristikat e përshkruara në akt. Nga krahasimi i profileve gjenetike arrihet në përfundim se profili gjenetik i shtetasit Gj.C është identik me profilin gjenetik të përfituar nga shishja me mbishkrimin 'S' marrë gjatë këqyrjes së mjetit me targë AA... Profili gjenetik i përfituar nga shtetasi Gj.C është i ndryshëm nga të gjitha profilet e tjera të përfituara nga provat materiale të ekzaminuara me aktin nr. \*\*\*, datë 20.2.2019... ”.*

Ndodhur në këto kushte është bërë ndalimi me iniciativë i shtetasit Gj.C për kryerjen e veprës penale “vrasje me paramendim” në bashkëpunim dhe “mbajtje pa leje i armëve shpërthyes dhe municionit”, parashikuar nga nenet 78-25 dhe 278 të Kodit Penal.

Në kuadrin e veprimeve hetimore për procedimin penal nr. \*\*\*, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, prokurori i çështjes Bajram Breçani i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila, me vendimin nr. \*\*\*, datë 1.6.2019, ka vendosur “Vlerësimin si të ligjshëm të ndalimit të personit nën hetim Gj.C, ‘arrest në burg’”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale.

Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur “Miratimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”. Më pas, shtetasi nën hetim me masën “arrest në burg” i drejtohet gjykatës me kërkesën për “Konstatimin e pavlefshëm të aktekspertimit biologjik krahasues ADN nr. \*\*\*..., datë 30.5.2019, papërdorshmëria e kampioneve biologjike marrë nga shishja me mbishkrimin ‘S’, e cila, me vendimin nr. \*\*\*, ka vendosur “Rrëzimin e kërkesës së personit nën hetim Gj. C. si të pabazuar në ligj e në prova”.

Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim personi nën hetim dhe Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur “Ndryshimin e vendimit nr. \*\*\*, datë 30.5.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në këtë mënyrë:

- pranimin e kërkesës;
- deklarimin si të papërdorshëm të aktekspertimit krahasues të ADN-së nr. \*\*\*..., datë 30.5.2019, të Institutit të Policisë Shkencore, për shkak të papërdorshmërisë së rezultatit të marrjes së kampionit biologjik të pështymës së personit nën hetim Gj. C., në datën 12.4.2018”.

Me vendimin e mësipërm, Gjykata e Apelit çmon se *akti objekt kërkimi është një veprim procedural që mund të kryhet në çdo kohë dhe organi i procedimit penal duhet të marrë, në respektim të plotë të procedurës së parashikuar në nenin 201/a të Kodit të Procedurës Penale kampionin e pështymës së personit nën hetim Gj. C., me qëllim të përcaktimit të profilin të ADN-së. Pas këtij veprimi hetimor rezultati i përfituar duhet t’i nënshtrohet një ekspertimi të ri për ta krahasuar me profilin gjenetik të përfituar nga shishja me mbishkrimin “S” marrë gjatë këqyrjes së mjetit me targa AA...*

- Vetëm pasi të jenë kryer të gjitha këto veprime hetimore do të kemi një zbatim ligjor të procedurës së marrjes së kampionit biologjik, në frymën dhe garancitë që parashikon neni 201/a i Kodit të Procedurës Penale.
- Më pas, personi nën hetim i drejtohet përsëri gjykatës së shkallës së parë me kërkesën për zëvendësim mase sigurimi nga ajo “arrest me burg” në një masë më të butë “garanci pasurore” ose “detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore”, ku kjo gjykatë e rrëzon këtë kërkesë. Gjykata e Apelit, me vendimin nr. \*\*\*, datë 4.9.2019, ka vendosur “Ndryshimin e vendimit nr. \*\*\*, datë 21.8.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në këtë mënyrë: pranimin e kërkesës së kërkuesit Gj. C.; zëvendësimin e masës së sigurimit “arrest në burg” për të pandehurin Gj. C. në atë të “detyrimin për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” çdo të hënë të parë të muajit në orën 13:00, sipas nenit 234 të Kodit të Procedurës Penale; urdhërohet lirimi i menjëhershëm i personit nën hetim Gj. C. nëse nuk mbahet për ndonjë vepër tjetër penale”.

- Ndaj këtij vendimi Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë nuk ka ushtruar rekurs.

Ndërsa, me vendimin nr. \*\*\*, datë 14.10.2020, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur:

- Pranimin e kërkesës së Prokurorisë.
- Pushimin e hetimeve në ngarkim të personit nën hetim Gj. C. për veprat penale “vrasje me paramendim” e kryer në bashkëpunim dhe “prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve luftarake apo municionit”, parashikuar nga nenet 78-2 dhe 25, 278 të Kodit Penal.
- Heqjen e masës së sigurimit personal të personit nën hetim Gj. P. C. “detyrimin për paraqitje në policinë gjyqësore” të parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale”.
- Mbi këtë vendim është ushtruar ankimi në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Sa më sipër, konstatohej se prokurori nuk ka zbatuar urdhërimet e Gjykatës së Apelit për kryerjen e një veprimi hetimor, atë të kryerjes së një aktekspertimi të ri me qëllim krahasimin e profilit gjenetik të përfutur nga shishja “S”.

Përkundrazi, duket se prokurori Bajram Breçani, me vendimin e datës 30.10.2019, “Për kryerjen ekspertimit biologjik vlerësues” nuk u përmbahet urdhërimeve të Gjykatës së Apelit në lidhje me mënyrën e marrjes së provës, pasi kjo e fundit deklaroi të papërdorshëm kampionin biologjik të pështymës së personit nën hetim Gj. C. dhe jo provën, profilin gjenetik të përfutur nga shishja me mbishkrimin “S”, marrë gjatë këqyrjes së automjetit me targa AA...

Në këtë mënyrë, jo vetëm ngatërrohet, por dyshohet se ky ngatërrim bëhet qëllimisht nga prokurori Bajram Breçani, i cili, për rrjedhojë dhe në vendimin përfundimtar të tij për pushimin e hetimeve, arsyeton dhe mbështet kryerjen e veprimeve hetimore në një vendim

tjetër të Gjykatës së Apelit Tiranë, me nr. \*\*\*, datë 4.9.2019, i cili ka vendosur “Zëvendësimin e masës së sigurimit nga ‘arrest në burg’ në ‘detyrim për paraqitje”.

Prokurori nuk ka kryer hetimet duke u bazuar në vendimin e Gjykatës së Apelit të formës së prerë, i cili ka vlerësuar dhe pranuar provën ADN të pështymës, marrë nga shishja “S” dhe ka urdhëruar përsëritjen e marrjen e provës së kampionit biologjik të pështymës të personit nën hetim për shkak të konstatimit të papërdorshmërisë në lidhje me arsyet e ngritura nga avokati mbrojtës i personit nën hetim (mosprezenca e avokatit gjatë marrjes së provës, etj.).

Prokurori, referuar edhe përgjigjes së administruar nga burime arkivore, me anë të shkresës kthim përgjigjeje drejtuar Drejtueses së Prokurorisë, ndër të tjera, citon: “... por, ky shtetas nuk ka dhënë pëlqim për dhënien e kampionit të ADN-së”. Pra, siç duket prokurori është mjaftuar me mosdhënien e pëlqimit nga ana e personit nën hetim, duke anashkaluar detyrimin ligjor që përcakton pika 5 e nenit 201/a, ku shprehimisht citohet: “... mbi bazën e kërkesës së prokurorit, gjykata mund të vendosë që marrja e kampionëve biologjikë ose procedura mjekësore të kryhet pa pëlqimin e personit, kur është e nevojshme dhe duke kufizuar lirinë e tij nëse nuk dëmtohet shëndeti i tij dhe nëse është e domosdoshme për të provuar faktet në procedim”.

Në këtë këndvështrim, duke parë e studiuar dispozitën e nenit 201/a të Kodit të Procedurës Penale, vërehet se prokurori, në zbatim të kësaj dispozite, por edhe të vendimit të Gjykatës së Apelit, duhej të kryente këtë veprim hetimor me qëllim vlerësimin, krahasimin dhe konkluzionin mbi këtë çështje.

- Nuk argumentohet nga subjekti si është kërkuar pushimi i hetimeve dhe procedimit penal ndaj shtetasit Gj. C., pa kryer detyrat e lëna nga Gjykata e Apelit dhe kryerjes së një aktekspertimi të ri për të krahasuar profilin gjenetik të përfituar nga administrimi i provës.
- Nuk argumentohet nga subjekti gjatë hetimit të kësaj çështjeje mbi çfarë baze është administruar një provë e marrë në datën 12.4.2018 (marrja e kampionit biologjik të pështymës të personit nën hetim), e cila është krahasuar me aktekspertimin krahasues të ADN-së nr. \*\*\*, datë 30.5.2019.
- Dukej se subjekti nuk ka kryer një sërë veprimesh hetimore të cituara nga denoncuesja në denoncimin nr. \*\*\*, datë 14.9.2021.
- Dukej se subjekti ka vazhduar ndjekjen e kësaj çështjeje penale edhe pas disa kallëzimeve penale të paraqitur nga bashkëshortja e viktimës ndaj tij.

Komisioni, duke analizuar këtë ankim të shtetasit/ish-bashkëshortes së viktimës A. B., por duke shqyrtuar edhe materialet arkivore të ardhura pranë Komisionit, ku kjo çështje trajtohet gjerësisht, ngarkoi me barrë prove subjektin për të provuar të kundërtën e këtyre konstatimeve e shkeljeve procedurale gjatë hetimit të çështjes, që lidhet me procedimin penal nr. \*\*\*.



Në lidhje me shpjegimet përfundimtare të subjektit të rivlerësimit për denoncimin e shtetasës M.B, subjekti ka prapësuar se *gjetjet e Komisionit nuk qëndrojnë*, pasi sipas tij: *“... menjëherë pas caktimit të masës së sigurimit për personin e dyshuar Gj. C. kam kërkuar nga shërbimet e policisë gjyqësore atë çfarë do të konstatonte më vonë Gjykata e Apelit, riekspertimin biologjik krahasues, tashmë duke marrë profilin gjenetik nga personi i arrestuar”*. Ai vijon me shpjegimin se: *“...në shqyrtimin e kërkesave të personit nën hetim të përshkruara më sipër, qëndrimi im në cilësinë e përfaqësuesit të organit të prokurorisë ka qenë për mospranimin e kërkesave, fakt i cili është në kundërshtim me atë çfarë pretendon dhe hedh dyshime të vazhdueshme shtetasja M.B për qëndrimin tim në ushtrimin e funksionit të prokurorit në trajtimin e kësaj çështjeje”*.

Komisioni mori në konsideratë edhe një herë çështjen dhe shkeljet procedurale të kryera nga subjekti i rivlerësimit.

Rezultoi se Gjykata e Apelit, me vendimin nr. \*\*\* datë 17.7.2019, ka vlerësuar se *rezultati i marrjes së kampionit biologjik të pështymës së personit nën hetim Gj. C. në datën 12.4.2018 është i papërdorshëm, në kuptim të paragrafit 14, të nenit 201/a të Kodit të Procedurës Penale dhe, për rrjedhojë, për të njëjtin shkak ligjor është i papërdorshëm edhe aktekspertimi krahasues i ADN-së nr. \*\*\*, datë 30.5.2019, të Institutit të Policisë Shkencore dhe ka kërkuar që organi i akuzës të marrë në respektim të plotë të procedurës së parashikuar në nenin 201/a të Kodit të Procedurës Penale kampionin e pështymës së shtetasit Gj. C. me qëllim të përcaktimit të profilit të ADN-së dhe pas këtij veprimi hetimor rezultati i përfutur duhet t'i nënshtrohet një ekspertimi të ri për ta krahasuar me profilin gjenetik të përfutur nga shishja me mbishkrimin “S”, marrë gjatë këqyrjes së mjetit*.

Edhe përfaqësuesi i organit të akuzës në këtë gjykim ka kërkuar deklarinimin si të papërdorshëm të aktekspertimit krahasues të ADN-së nr. \*\*\*, datë 30.5.2019, të IPSH-së për shkak të papërdorshmërisë së rezultatit të marrjes së kampionit biologjik të pështymës së personit nën hetim Gj. C., në datën 12.4.2018.

Ndërsa, vendimi nr. \*\*\*, datë 4.9.2019, i Gjykatës së Apelit ka vendosur *“Zëvendësimin e masës së sigurimit nga ‘arrest me burg’ në ‘detyrim për paraqitje”*. Kjo gjykatë ka bërë të papërdorshëm në procesin penal provën materiale të emërtuar me nr. \*\*\* shishja “S” (një ndër shumë prova materiale të sekuestruara në mjet), në procesverbalin e këqyrjes së vendit të ngjarjes të datës 1.2.2019, ora 16:30, duke deklaruar se *veprimet e policisë gjyqësore për marrjen, fiksimin dhe sekuestrimin e kësaj prove materiale, shishes “S”, janë haptazi në shkelje të rëndë të ligjit*.

Nga ky vendim i datës 4.9.2019, dukej si e pamundur përsëritja e marrjes së materialit gjenetik nga prova e vetme e sekuestruar në vendin e ngjarjes shishe “S” (shihni shpjegimin që bën IPSH në korrespondencën me organin e akuzës), por prokurori, në zbatim të vendimit nr. \*\*\*, datë 17.7.2019, duhej të urdhëronte rimarrjen, në respektim të plotë të procedurës së parashikuar nga neni 201/a i Kodit të Procedurës Penale, kampionin e pështymës së shtetasit Gj. C., me qëllim të përcaktimit të profilit të ADN-së dhe nga

rezultati i përfutur të bëhej krahasimi me profilin gjenetik të përfutur nga shishja me mbishkrimin "S", marrë gjatë këqyrjes së mjetit.

Duke parë edhe dokumentacionin e sjellë nga subjekti në mbështetje të shpjegimeve përfundimtare në seancën dëgjimore të datës 1.9.2022, Komisioni konkludon se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të kësaj çështjeje, nuk ka respektuar dhe zbatuar në mënyrë rigoroze dispozitat që përcakton neni 201/a i Kodit të Procedurës Penale, sepse siç është thënë edhe në përfundim të rezultateve të hetimit, prokurori, referuar edhe përgjigjes së administruar nga burime arkivore, me anë të shkresës kthim përgjigjeje drejtuar Drejtueses së Prokurorisë, ndër të tjera, citon: "... por, ky shtetas nuk ka dhënë pëlqim për dhënien e kampionit të ADN-së". Pra, siç duket, prokurori është mjaftuar me mosdhënien e pëlqimit nga ana e personit nën hetim, duke anashkaluar detyrimin ligjor që përcakton pika 5 e nenit 201/a.

Siç shihet edhe nga dokumentacioni që subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion në seancën dëgjimore të datës 1.9.2022, në cilësinë e prokurorit të çështjes, ka kryer një sërë veprimesh hetimore në lidhje me hetimin e kësaj çështjeje, por konstatohet se disa prej këtyre veprimeve hetimore nuk janë kryer në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, si dhe duhej patjetër të merrte masa të menjëhershme dhe të ngutshme që në zbatim të vendimit nr. \*\*\*, datë 17.7.2019, të Gjykatës së Apelit të kryente veprimin hetimor (të urdhëronte rimarrjen e kampionit të pështymës së shtetasit GJ. C., me qëllim të përcaktimit të profilit të ADN-së) me qëllim vlerësimin, krahasimin dhe konkluzionin mbi këtë çështje, gjithmonë në referim të dispozitës së nenit 201/a të Kodit të Procedurës Penale.

Gjithashtu, subjekti, i pyetur gjatë seancës dëgjimore nga Komisioni në lidhje me këtë çështje, shprehu edhe mungesë etike në drejtim të denoncueses M. B.

Në përfundim, Komisioni, duke analizuar edhe shpjegimet përfundimtare të subjektit në seancën dëgjimore, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë bindshëm arsyet që kanë çuar në vendimin e pushimit të procedimit penal nr. \*\*\*, pa kryer të gjitha veprimet e duhura hetimore. Kjo mënyrë e të trajtuarit të çështjes u pa si mangësi profesionale nga ana e subjektit të rivlerësimit Bajram Breçani.

Në analizën përfundimtare, Komisioni vlerësoi se, pavarësisht këtyre mangësive profesionale të evidentuara, rëndësia e shkeljeve nuk është në masën ose që të përbëjnë shkaqe për të cilën duhet të aplikohet neni 61/4 i ligjit nr. 84/2016.

## **VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES**

Në vlerësimin tërësor të çështjes, mbështetur në provat, faktet dhe rrethanat që Komisioni disponon për kriterin e vlerësimit të pasurisë, vlerësimit të figurës dhe vlerësimit profesional, si dhe në vlerësim tërësor të procedurave, arrin në përfundimin se:

## **Për vlerësimin e pasurisë**

Komisioni, bazuar në provat që disponon, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe bindjen e brendshme, çmon se faktet në lidhje me kriterin e pasurisë të krijojnë bindjen se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë pasuritë dhe ligjshmërinë e burimit të krijimit, për arsytet e përmendura në këtë vendim në kriterin “Vlerësimi i pasurisë”.

Rezultoi se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë, të paplotë dhe ka mungesë të burimeve financiare lidhur me pasuritë. Rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pamundësi financiare për blerjen e pasurive, për të përballuar me burime të ligjshme financiare kryerjen e shpenzimeve dhe shtesën e kursimeve ndër vite, duke rezultuar me një mungesë burimesh të ligjshme në vlerën 2.449.229 lekë.

Komisioni konstatoi se subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për pasuritë, si dhe nuk justifikon me burime të ligjshme krijimin e tyre, duke u gjendur në kushtet e parashikimit të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

Duke u gjendur në këtë mënyrë në plotësim të kushteve të parashikuara nga pika 1 e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, e cila parashikon se: *“Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklaramit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur”*, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë pasuritë në pronësi.

Pika 3 e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, parashikon se: *“Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj”*, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave të përmendura në këtë vendim.

Pika 5 e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, parashikon se: *“Nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të fshehtë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën”*, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë.

Pra subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e pikës 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

Subjekti nuk gjendet në kushtet e germës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” pasi deklarimi i pasurive nuk është i saktë dhe në përputhje me ligjin.

Në rastin e subjektit të rivlerësimit Bajram Breçani, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, vërtetohen shkaqet që neni D i Kushtetutës i ka parashikuar të tilla që të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

Mbështetur në konkluzionet e mësipërme, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit Bajram Breçani nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, në kuptim të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

### **Për vlerësimin e figurës**

Nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit rezultuan të sakta dhe të vërteta. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Bajram Breçani ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

### **Për vlerësimin e aftësive profesionale**

Në përfundim, lidhur me kriterin profesional për pesë çështjet e shortuara, trupi gjykues, pas vlerësimit të parashtrimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti dhe propozimit të relatorit të çështjes, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel minimal kualifikues, në kuptim të germës “c”, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me denoncimet, trupi gjykues konstatoi disa shkelje të subjektit të trajtuar më sipër në këtë vendim, por u konsiderua një rast i vetëm që nuk përbën shkak për penalizimin e subjektit lidhur me kriterin e vlerësimit profesional.

## **KONKLuzion Përfundimtar**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konstaton nga vlerësimi i kriterit të pasurisë, sipas paragrafit 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016 dhe arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit Bajram Breçani ka arritur nivel të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, duke u gjendur në kushtet e pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jakobs, referuar germës “c”, të pikës 1, të nenit 58 dhe të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

## **V E N D O S I:**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Bajram Breçani, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.  
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 6.9.2022.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Pamela QIRKO**  
Kryesuese

**Roland ILIA**  
Relator

**Etleda ÇIFTJA**  
Anëtare

*Sekretare gjyqësore*  
*Amela Idrizi*